

BISMIL'LAHI'R-RAHMANI'R-RAHIM

RENDITJA E VIRIDIT DHE IBADETET E NATËS

Imam Gazali

Prishtinë 2019

Ihjaü Ulumid-din
Ringjallja e diturive fetare
Imam Gazali

Titulli i origjinalit:
KITABU TERTIBI'L-EVRAD VE TAFSIL-I IHJAI'L-LEJL
LIBRI 10

Përgatiti dhe përktheu:
Is-hak Shala dhe Abdullah B. Ferizi

Lektor:
Shenaj Zeneli

Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit

PARATHËNIE

Hamd i takon vetëm Allahut Teala, Atë e lavdërojmë dhe Atë e falënderojmë, që na dhuroi mirësi (nimet) pafund. Allahun e përmendim në zemrat tona, me përulësi dhe sinqeritet. Falënderim pafund Allahut Teala që i krijoi ndërrimin mes natës e ditës, që ato të vijjnë njëra pas tjetrës për ata që dëshirojnë ta mendojnë Krijuesin Fuqplotë dhe urtësinë e Tij dhe ta falënderojnë për nimetet e Tij.

Salat dhe selam Mahammedit s.a.v.s., që është dërguar si sihariqdhënës për ata që besojnë dhe frikësues për ata që nuk besojnë; dhe familjes së tij (ehlibejtit), si edhe as'habëve të tij të pastër e fisnikë. Secili prej tyre, me ibadete të vazhdueshme, natë e ditë, u bë një yll dhe pishtar që ndriçon errësirën, për t'ju treguar njerëzve rrugën e drejtë të fesë.

Pas kësaj, dije se Allahu Teala ia nënshtroi Tokën robëve të Vet dhe e bëri të përshtatshme për udhëtimin e tyre, e jo që aty të qëndrojnë përgjithmonë, por si konak të përkohshëm, ku do të sigurojnë sevape e vepra të mira, që i dërgojnë në lumturinë e përjetshme dhe në vatanin e vërtetë, në xhennet.

Duke shmangur rreziqet dhe kurthet e dynjasë, e duke u shërbyer me nimete nga të gjitha anët e saj, robët e Allahut përfitojnë dituri dhe cilësi të bukura si virtyt, dhe e kuptojnë se jeta e tyre, bashkë me botën, vazhdimisht lundron, si një anije me udhëtarë. Njerëzit në këtë botë janë në udhëtim të vazhdueshëm; stacioni i tyre i parë është djepi, e i fundit varri, e vendqëndrim i përhershëm është xheneti ose xhehenemi. Gjatësia e kësaj rruge është jeta. Vitet janë etapa, muajt segmente, ditët kilometra, e frymët janë hapa. Ibadetet dhe veprat e mira janë pasuri, e pasuria më e madhe është koha. Epshtet dhe dëshirat e nefsit janë hajdutë të kësaj rruge. Fitimi i njeriut është rizaja e Allahut Teala, xheneti, nimetet që janë aty dhe shikimi i bukurisë së Allahut, e humbje është përballja me vuajtje të shumëllojshme në xhehenem dhe largimi nga rahmeti dhe bukuria e Allahut. Ata që e harxhojnë kot qoftë edhe një frymë nga pasuria e jetës së tyre, e nuk e përdorin në mirësitë që afrojnë Allahut, në ditën e kijametit do të pendohen shumë. Kush e kuptoi këtë rrezik të tmerrshëm, u mundua me të gjitha forcat që pjesën e mbetur të jetës ta harxhojë në perfitimin e rizasë së Allahut. Për t'ju afruar Allahut në ahiret, ata ditët dhe netët i kalonin në ibadet dhe u kujdesën që kohën ta harxhojnë në mirësitë që ju mundësojnë rizanë e Allahut. Kështu, ibadetin dhe vird¹in e lidhën për kohë të caktuara. Ndarjen e kohës së caktuar për ibadet dhe virde llogaritën si dituri të rëndësishme në rrugë të ahiretit. Ne këtë do ta shpjegojmë në dy kapituj,

¹ *Vird*: dhikër i rregullt e i vazhdueshëm; shumës: *evrad*.

Kapitulli i parë

VLERA E LARTË, RENDITJA DHE RREGULLAT E VIRIDIT

Dije se ata që panë me syrin e zemrës e kuptuan që shpëtimi është vetëm në arritjen e rizasë (kënaqësisë) së Allahut Teala, e për të arrit rizanë e Allahut duhet njohja e Allahut Teala dhe dashuria ndaj Tij; e me këtë marifet² e dashuri, të vdesë.

Ata mësuan që në hakikat, përpos Allahut dhe veprave të Tij (*ef'al*), nuk ka asgjë tjetër, dhe që dashuria për Allahun mund të arrihet me dhikër të vazhdueshëm dhe që marifeti arrihet duke menduar vazhdueshëm për Allahun Teala, për Qenien (Dhat) e Tij, cilësitë (sifat) e Tij dhe veprat (*ef'al*) e Tij, kur braktisen epshet për dynjanë e merret nga ajo vetëm sa ka nevojë.

Që kjo të arrihet, dhikri dhe mendimi duhet të jenë të vazhdueshëm, natë e ditë. Nefsi i njeriut për nga natyra mërzitët shpejt, e kur një lloj i njëjtë i ibadetit bëhet në vazhdimësi, në të njëjtën mënyrë, nefsi tregon shenja të dembelisë e mërzitjes. E meqë butësia ndaj shpirtit është obligim, është bërë e domosdoshme që kohët për ibadet të ndahen, që të merret kënaqësi prej tij, e me këtë kënaqësi të pushohet nefsi e të shtohet dëshira për ibadet të vazhdueshëm.

² **Marifet:** njohuri; dituri; dituri që fitohet me mendim; njohja e të vërtetës; ta njohësh Hakkun; aftësi; zotësi;

Për nga natyra, nefsi anon kah dynjaja, prandaj, për ta mposhtur nefsin njeriu duhet të jetë vazhdimisht i angazhuar me dhikr dhe mendim.

Nëse e ndanë kohën në dy pjesë, e gjysmën e kohës e kalon në dhikr e mendim ndërsa gjysmën tjetër duke iu përshtatur dëshirave të nefsit, te nefsi do të mbizotëronte dynjallëku, sepse edhe i përshtatet me natyrën e vet. Meqë kohët janë të barabarta, nefsi nuk do të mposhtet, pasi që për nga natyra më shumë anon kah njëra, dhe, edhe e jashtëmja (*zahir*) edhe e brendshmeja (*batin*) e tij janë përshtatshëm dynjasë. Duke anuar kah dynjallëku, zemra i jep rëndësi asaj, prandaj është vështirë që njëkohësisht edhe të lidhet plotësisht në ibadet dhe në zbatim të urdhrave të shariatit, që të sigurojë qetësi shpirtërore. Ibadeti i vjen si detyrim, dhe vetëm nganjëherë bëhet me zemër të qetë.

Ata që dëshirojnë të hyjnë në xhenet pa u pyetur dhe pa dhënë përgjigje, le ta harxhojnë tërë kohën në ibadet, e ata që dëshirojnë sevapet të ju peshojnë më shumë se gjynahet, duhet shumicën e kohës së tyre ta harxhojnë në ibadet. Atë që e kanë harxhuar gjysmën e jetës në kundërshtim e gjysmën me ibadet janë në rrezik, por as për ta shpresa te Allahu nuk duhet të ndërpritet, sepse Gjithëfalësi (*Gafar*) mund t'i falë.

Pra, këto që i shpjeguar janë hakikatet që ju shfaqen atyre që shikojnë me syrin e zemrës. Nëse ti nuk je prej tyre, shiko si i drejtohet Allahu Teala pejgamberit të Tij të dashur dhe pranoje atë me nurin e imanit;

Robit të tij më të afërt, atij që është në shkallën më të lartë, Muhammedit, s.a.v.s., Allahu Teala kështu i thotë:

“Vërtet, ti gjatë ditës ke angazhim të gjatë (të madh).

Por ti përmende Rabbin tënd dhe plotësisht përkushtoj Atij!” 73-Muzzemmil: 7, 8.

“Përmende emrin e Rabbit tënd në mëngjes dhe në mbrëmje,

Dhe, në një pjesë të natës kryej detyrat (falu) për Rabbin, dhe falënderoj Atë natën, gjatë!”

76-Insan: 25, 26.

“...madhëroje Rabbin tënd e falënderoj Atë para lindjes së diellit dhe para perëndimit.

Madhëroje Atë edhe në një pjesë të natës, edhe pas faljes së namazit.” 50-Kaf: 39, 40.

“Iavdëroje duke e falënderuar Rabbin tënd kur të ngritesh,

dhe, madhëroje Ate edhe natën edhe pas perëndimit të yjeve!” 52-Tur:28, 49.

“Zgjuarja natën, me të vërtetë, vepron më fuqishëm dhe shprehjet (mësimet) janë më të kthjellta.” 73- Muzzennil: 6.

“Prandaj duroje (o Muhamed) atë që thonë ata dhe lavdëroje me falënderim Rabbin tënd para lindjes së Diellit dhe para perëndimit të tij! Lavdëroje Atë edhe në orët e natës, edhe në skajet e ditës, ashtu që të gjesh kënaqësi (me shpërblim).” 20-Ta Ha: 130

“Fale namazin në dy skajet e ditës, e edhe në orët e afërta (me ditën) të natës. S'ka dyshim se veprat e mira i shlyejnë ato të këqijat. Kjo është një këshillë për ata që pranojnë këshillat.” 11-Hud: 114.

“(A më i mirë është ky) apo ai që bën lutje natën, duke bërë sexhde dhe duke qëndruar në këmbë e që ruhet (nga dënimi) i jetës tjetër dhe shpreson në mëshirën e Rabbit të tij...? Thuaj: *“A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë? Vetëm mentarët i pranojnë këshillat!”* 39-Zumer: 9.

“Ata ngrihen nga shtrati, i luten Rabbit të tyre me frikë e shpresë.” 32-Sexhde: 16.

“Ata që e kalojnë natën, duke i bërë sexhde Rabbit të tyre, dhe duke ndenjur në këmbë.” 25-Furkan: 64.

**“Ata, kanë fjetur pak natën,
dhe në agim kërkonin falje.” 51-Dharijat: 17, 18.**

“Allahun lartësojeni kur të vijë mbrëmja dhe kur të ajojë mëngjesi.” 30-Rum: 17

“Mos i dëbo ata që i luten Rabbit të vet në mëngjes e mbrëmje, duke e dëshiruar Atë.” 6-Enam: 52

Të gjitha këto ajete tregojnë rrugën që shkon Allahut, e duke bërë kontrollimin e kohës, ibadeti i vazhdueshëm është i mundur. Edhe Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

“Robi më i dashur tek Allahu është ai që vrojton Diellin, Hënën dhe hijen për të përkujtuar (dhikër) Allahun.”³

Ndërsa në një ajet, Allahu Teala thotë:

“Dielli dhe Hëna (lëvizin) sipas llogarisë (rrugës) së caktuar.” 55-Rrahman: 5,

e me një ajet tjetër:

“A nuk e ke parë ti se si Rabbi yt e ka zgjatur hijen?! Sikur të kishte dashur, do ta bënte të pandryshueshme? Pastaj Ne e kemi bërë Diellin udhëzues të saj,

pastaj e tërheqim atë (hijen), dalëngadalë pranë Vetes.”25-Furkan:45, 46,

dhe:

“Edhe Hënës i kemi caktuar fazat (pozicionet).”

36- Ja Sin: 39,

³ Taberani dhe Hakimi nga Ibn Ebi Evfa.

dhe:

“Ai është që krijoi yjet për ju që me ta të orientoheni në errësira kur jeni në tokë ose në det.”

6-Enam: 97.

Mos mendo që krijimi i Diellit dhe Hënës dhe lëvizjet e tyre në një mënyrë të caktuar është vetëm të rregullohen punët e dynjallëkut. Qëllimi kryesor është që, duke i përcjellur ato lëvizje, të caktohet koha për të fituar ahiretin.

Ndërsa Allahu Teala thotë:

“Ai krijoi natën dhe ditën që të vijnë njëra pas tjetrës, si këshillë për ata që duan ta kujtojnë ose ta falënderojnë.” 25-Furkan:62.

Ajeti njofton qartë dhe e bën të kuptueshme se qëllimi kryesor është dhikri dhe falënderimi.

E me një ajet tjetër:

“Ne i kemi bërë natën dhe ditën dy argumente (që dëshmojnë fuqinë Tonë); e kemi shlyer argumentin e natës, kurse argumentin e ditës e kemi bërë të ndritshëm, për të kërkuar ju dhunti nga Rabbi juaj, dhe që ta dini numrin e viteve dhe njehsimin e kohës.”

17-Isra: 12.

Dhuntia që përmendet në këtë ajet arrihet me durim, e vlera e lartë dhe sevapi i saj, padyshim që është falja nga Allahu Teala. Nga Ai kërkohet ta na mundësojë vepra me të cilat Ai është razi.

NUMRI DHE RENDITJA E EVRADIT

Dije se janë shtatë evrade (ibadet) ditore:

- Një vird është prej para agimit deri në lindjen e diellit;
- Dy virde janë prej lindjes së Diellit: njëri deri në namazin e duhasë, e i dyti deri në drekë;
- Dy virde janë prej drekës deri në ikindi; dhe
- Dy virde janë prej ikindisë deri në aksham.

Virde të natës janë katër:

- Dy virde janë prej akshamit deri në kohën e gjumit; dhe
- Dy virde janë prej gjysmës së natës deri në agim.

Tani do ta shpjegojmë vlerën e lartë (*fazilet*) të virdit, dhe zbatimin e tij.

EVRAZI DITOR

Viridi i parë ditor është koha prej para agimit deri në lindjen e diellit. Kjo është kohë shumë e vlefshme. Allahu Teala betohet në të:

“Pasha agimin kur zbardhon!” 81-Tekvir: 18;

pastaj lavdërohet me të:

“Ai është krijues i dritës së mëngjesit” 6-Enam: 96.

“Thuaj: *I mbështetem Rabbit të agimit.*”

113-Felek: 1.

E tregon edhe fuqinë e Tij, duke e tërheq terrin dhe duke sjellë dritë:

“pastaj e tërheqim atë (hijen), dalëngadalë pranë Vetes.” 25-Furkan:46.

Kjo është koha kur terri i natës tërhiqet para dritës së Diellit; që është kohë shumë e vlefshme për ibadet, prandaj Allahu Teala i thërret njerëzit që në atë kohë ta lavdërojnë:

“Allahun lartësojeni kur të vijë mbrëmja dhe kur të agojë mëngjesi.” 30- Rum: 17, dhe:

“Lavdëroje me falënderim Rabbin tënd para lindjes së Diellit dhe para perëndimit të tij! Lavdëroje Atë edhe në orët e natës, edhe në skajet e ditës, ashtu që të gjesh kënaqësi.”20-Ta Ha: 130, dhe:

“Përmende emrin e Rabbit tënd në mëngjes dhe në mbrëmje.” 76-Insan: 25.

Pasi u kuptua *fazileti* i kësaj kohe, le ta shpjegojmë renditjen e ibadetit në të;

Viridin e fillon me zgjimin prej gjumit, duke përmendur Allahun siç e shpjeguam në *Librin për duatë*, e duhet të lexohet:

Hamd Allahut Teala, i Cili na zgjoi (nga gjumi) pasi na vuri në gjumë si të vdekurin. (El-hamdu lil-lahil-ledhi ahjana ba'de ma ematena ve ilejhim-nushur.)

I veshë rrobat, me duanë përkatëse, e me qëllim të mbulohet lakuriqësia, me çka shprehë nënshtrim ndaj urdhrit të Allahut dhe përgatitet për ibadet, pa shtirje e fjalë boshe.

Niset për toalet, nëse ka nevojë, e hyn me këmbën e majtë, përcjellë me duanë përkatëse të përmendur në librin *Fshehtësitë e pastërtisë*. I pastron dhëmbët me misvak, sipas rregullave që i kemi shpjeguar, dhe merr abdes, si duhet, bashkë me duatë përcjellëse, që njëjtë i kemi përmendur në librin *Fshehtësitë e pastërtisë*.

Pas abdesit i falë dy reqate sunnet të sabahut në shtëpi, siç bënte Resulallahu, s.a.v.s.,⁴ e më pas, edhe nëse i falë në xhami, lexon duanë që e përcjellë Ibn Abbas, r.a.:

Allahumme inni es'eluke rahmeten min indike tehdî biha kalbi...(Rabbi im, më mëshiro dhe udhëzoje zemrën time...)⁵

Pastaj del nga shtëpia dhe niset drejt xhamisë, dhe nuk harron duanë e nisjes për në xhami. Rrugës nuk ngutet⁶, por ecë qetë e me dinjitet, siç tregojnë hadithet e Resulallahut, s.a.v.s., dhe nuk i ndërthur gishtat. Në xhami hyn me këmbën e djathtë, duke lexuar duanë e duhur.⁷ Kërkon vend në safin e parë, nëse ka, duke mos kaluar përmbi krahët e të tjerëve dhe duke mos i shtyer ata. Atëherë i falë dy reqate sunnet të sabahut, nëse

⁴ Hadith muttefekun alejhi, Buhari dhe Muslim nga Hafsa.

⁵ Hadithi tashmë është përmendur.

⁶ Hadith muttefekun alejhi, Buhari dhe Muslim nga Ebu Hurejre.

⁷ Hadithi është përmendur në kapitullin e pestë të Librit për dhikrin.

nuk i ka falë në shtëpi, dhe lexon duanë përkatëse që e përmendëm. Nëse sunnetin e ka falë në shtëpi, atëherë me mbërritje në xhami i falë dy reqate *tehijjetul-mesxhid*, e më pas ulet dhe pret të mblidhet xhemati.

Më e vlefshmja është të falet namazi i sabahut me lajmërimin e agimit të parë, sepse kështu vepronte edhe Resulallahu, s.a.v.s..⁸ Nuk duhet lëshuar namazin me xhemat, posaqërisht namazin e sabahut dhe të jacisë, meqenëse janë më të vlefshëm se të tjerët.

Enes b. Malik tregon se Resulallahu, s.a.v.s., në lidhje me namazin e sabahut, ka thënë:

“Kush merr abdes e niset për në xhami të falë namaz, për secilin hap deri te xhamia do t’i shënohet një vepër e mirë, e do t’i fshihet një vepër e keqe. Secila prej atyre veprave të mira do t’i vlejë sa dhjetë të tilla në raste tjera. Nëse përfundon namazin dhe largohet nga xhamia në kohën kur del dielli, për secilën qime në trupin e tij do t’i shënohet nga një vepër e mirë, e do t’i vlejë sikur të ketë kryer haxhin pa gjynahe. Nëse qëndron në xhami për të falë edhe namazin e duhasë, për secilin reqat do t’i shkruhen dy milionë vepra të mira. E kush e falë në xhami jacinë (me xhemat), do t’i shkruhen edhe aq (vepra të mira), dhe do t’i vlejë sikur të ketë kryer umren pa gjynahe.”⁹

⁸ Hadith muttefekun alejhi, Buhari dhe Muslim nga Ajsha, r.anha..

⁹ Hadithi nuk është gjetur në këtë formë. Në veprën *Shuabul-iman* të Bejhekiut përmendet hadithi nga Enes b. Malik me zinxhir të dobët të transmetuesve, ku thuhet: *“Kush falë namazin e akshamit*

Gjeneratat e para të myslimanëve e kishin zakon të vinin në xhami para agimit.

Kështu, njëri prej taibinëve tregon se hyri në xhami herët para agimit, e atje e gjeti Ebu Hurejren, i cili e pyeti përse kishte dalë nga shtëpia në atë kohë, e kur ky i tregoi se ka dalë për namazin e sabahut, Ebu Hurejre i tha: *“Gëzohu! Vlerën e daljes nga shtëpia për në xhami në këtë kohë ne e konsideronim me vlerën e luftës në rrugë të Allahut Teala dhe me vlerën e luftës bashkë me Resulallahun, s.a.v.s..”*

Alia, r.a., tregon se Resulallahu, s.a.v.s., një mëngjes trokiti në derën e tij e të Fatimes, r.anha, dhe i pyeti:

- **A nuk jeni në namaz ju të dy?**, e Alia r.a., i tha:

- *O Resulallah, shpirtat tanë janë në Dorën e Allahut, kur të do Ai, i zgjon.*

Hazreti Alia r.a., e dëgjoi Resulallahun, s.a.v.s., të largohej, e duke goditur gjoksin e vet, thoshte:

- **Njeriu është më i ashpri në argumentim!**¹⁰

Pas dy reqateve sunnet të sabahut dhe leximit të duave, i kushtohet kërkim faljes nga Allahu dhe lavdërimin të Tij:

Estagfirul-lahel-ledhi la ilahe ila huvel-hajjul-kajjumu ve etubu ilejhi (Kërkoj falje nga Allahu Teala, të Gjallit e të Përhershmit, nuk ka zot tjetër pos Tij, dhe te Ai pendohem), 70 herë, dhe:

në xhemat, do t'i vlejë sikur të ketë kryer haxhin pa gjynahe, dhe Allahu Teala do t'ia pranojë një umre.”

¹⁰ Muttefekun alejhi, Buhari dhe Muslim

Ve subhanal-lahi, vel-hamdu lil-lahi, ve la ilahe illallahu val-lahu ekber (Lavdëruar qoftë Allahu, Atij i takon hamdi, nuk ka zot tjetër pos Allahut, Madhështorit), 100 herë.

Më pas e falë farzin e sabahut, duke u kujdesur për rregullat e namazit, siç i kemi shpjeguar, e pastaj vazhdon të qëndrojë në xhami deri në daljen e Diellit, duke e përmendur Allahun Teala. Në lidhje me këtë, Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

“Të jem me ata që përmendin Allahun nga fillimi i mëngjesit deri në lindjen e diellit, më është më e dashur se sa të liroj katër skllavë.”¹¹

Në disa transmetime thuhet se, pasi e falte namazin e sabahut, Resulallahu, s.a.v.s., ulej, deri sa të lindë Dielli, e në transmetime tjera thuhet se pasi të lindë Dielli i falte edhe dy reqate.¹² Ka plot transmetime që tregojnë vlerën e kësaj. Hasan Basriu ka treguar se Resulallahu, s.a.v.s., po fliste për mëshirën e Allahut, dhe tregoi që Allahu Teala ka thënë:

“O njerëz, më bëni dhikr Mua një orë pas namazit të sabahut dhe një orë pas ikindisë, e Unë ju kursej nga ajo që është në mes.”¹³

¹¹ Ebu Davudi nga Enes b. Malik. Hadithi është përmendur në *Librin për diturinë*.

¹² Muslimi, nga Xhabir b. Semur, pa përmendjen e dy reqateve, dhe Tirmidhi nga Enes b. Malik, që e konsideron të mirë: “*Kush e falë namazin e sabahut dhe vazhdon të qëndrojë ulur, e më pas i falë dy reqate, do të ketë shpërblim sikur të ketë kryer haxhin dhe umren*”.

¹³ Ibn Mubarek në veprën Zuhd, si hadith mursal.

Duke pasë parasysh këto vlera të larta, le të ulet në heshtje, deri në lindje të Diellit, me obligimet e tij: *duatë, dhikri, leximi i Kur'anit, dhe tefekkur* (të menduarit).

DUATË

Sa herë e përfundon namazin, e lexon duanë:

Allahumme sali ala Muhammedin ve ala ali Muhammedin ve sellim. Allahumme entes-selamu ve minkes-selamu ve ilejke je'udus-selam. Hajjina rabbena bis-selami ve edhilna dares-selami tebarekte ja dhel-xhelali vel-ikram. (Rabbi im, bekoje dhe shpëtoje Muhammedin, s.a.v.s., dhe familjen e tij. Rabbi im, Ti je i pastër nga çdo e metë, prej Teje vjen shpëtimi, Ty të dorëzohemi, na ringjallë në paqe dhe na dërgo në shtëpinë e shpëtimit. I Lavdëruar je, i Lartësuar, Fisnik).

Më pas, ashtu siç ka bërë dua Resulallahu, s.a.v.s.:

Subhane rabbijel-alijil-e'lal-vehhab. La ilahe illallahu vahdedu la sherike leh. Le hul-mulku ve le hul-hamdu juhji ve jumitu ve huve hajjun la jemutu, bi jedihil-hajru ve huve ala kuli shej'in kadir. La ilahe illallahu ehlun-ni'meti vel-fadli ves-senail-hasen. La ilahe illallahu ve la na'budu ila ijyahu muhlisine lehud-dine ve lev kerihel-kafirun (I lavdëruar qoftë Rabbi im i Lartë, i Cili dhuron shumë. Nuk ka zot tjetër pos Allahut, Një dhe i Vetmi. Ai nuk ka partner. Atij i takon gjithë pushteti dhe falënderimi. Ai është i Cili e dhuron jetën dhe vdekjen. Ai është i Gjalli, i Cili nuk vdes. Në duart e Tij është e mira, dhe Ai mund të bëjë gjithçka.¹⁴

¹⁴ Nga Ebu Ejjub, thuhet se përsëritet 10 herë por nuk përmenden fjalët: "Ai është i Cili e dhuron jetën dhe vdekjen. Ai është i Gjalli, i

Nuk ka zot pos Allahut, Mirëbërësit, Mëshiruesit. Nuk ka zot tjetër pos Allahut. Vetëm Atë e adhurojmë dhe vetëm besimin në Të e tregojmë, edhe nëse kjo është e pakëndshme për pabesimtarët).

Pasojnë duatë që i përmendëm në kapitujt 3 e 4 të *Librit për duatë*, i lexon të gjitha nëse mundet, ose vetëm ato që vlerëson se përshtaten me gjendjen e tij, që janë më të dashura për zemrën e tij e më të lehta për gjuhën e tij.

DHIKRI

Dhikr janë fjali, që në përsëritjen e tyre ka vlera për çka nuk kemi folë gjerësisht. Së paku duhet të përsëriten 3 ose 7 herë, e më së shumti 70 ose 100 herë. Mesatarja është 10 herë, e secili le t'i përsërisë aq sa ka mundësi. Në pak përsëritje ka pak sevap e në shumë përsëritje ka shumë sevap. Megjithkëtë, më e vlefshme është përsëritja 10 herë vazhdimisht se sa herë pas here 170 herë. Sepse dhikri i vazhdueshëm ndikon më shumë në zemër. Pak dhikr, por që bëhet në vazhdimësi, është si shembulli i pikave të ujit - nëse bien vazhdimisht në gur, edhe aty lënë gjurmë. Edhe dhikri që bëhet një herë ose që shumë rrallë përsëritet është si shembulli i ujit, kur rrjedhë në tokë por nuk lë kurrfarë gjurme. Të gjitha këto janë dhjetë fjali:

Cili nuk vdes. Në duart e Tij është e mira..." Këtë e gjejmë te Nesai, nga Ebu Zerr. Duanë të plotë e shënon Bezzar (përsëritet 100 e 200 herë) nga Abdurrahman b. Avf, si dhe Taberani (100 herë), nga Abdullah b. Amr, me zinxhir të dobët.

1. La ilahe illallahu vahdedu la sherike leh. Leहुल-mulku ve lehul-hamdu juhji ve jumitu ve huve hajjun la jemutu, bijedihil-hajru ve huve ala kulli shej'in kadir. (Nuk ka zot tjetër përpos Allahut, Një dhe të Vetmit. Ai nuk ka partner. Atij i takon gjithë pushteti dhe lavdërimi. Ai është i Cili jep jetën dhe vdekjen. Ai është i Gjalli, i Cili nuk vdes. Në duart e Tij është e mira, dhe Ai mund të bëj gjithçka.)¹⁵

2. Subhanal-lahi vel-hamdu lil-lahi ve la ilahe ilallahu val-lahu ekber. ve la havle ve la kuvvete ila bil-lahil-alijil-adhim. (I lavdëruar qoftë Allahu Teala. Hamdi i takon Allahut Teala. Nuk ka zot tjetër përpos Allahut Teala. Allahu është Madhështori. Nuk ka fuqi pa Allahun, Madhështorin dhe të Lartësuarin).

3. Subbuhun kuddusun rabbul-mela'iketi ver'ruh. (Ai është i Lavdëruari dhe i Bekuari dhe Ai është Rabbi i melekëve dhe i Xhebrailit).¹⁶

4. Subhanallahil-adhimi ve bi hamdihî. (I lavdëruar qoftë Allahu Teala dhe hamd i qoftë Atij).¹⁷

¹⁵ Tashmë është përmendur. Ebu Ejjub thotë se duhet përsëritur 10 herë, pa fjalët: *juhji ve jumitu ve huve hajjun la jemutu, bijedihil-hajr*. Kjo gjendet në *El-jevum vel-lejle* të Nesait, nga Ebu Zerr, pa fjalët *ve huve hajju la jemut*. Verzioni i plotë te Bezzar, nga Abdurrahman ibn Avf, në pjesën ku përmendet dhikri i mëngjesit dhe i mbrëmjes, dhe thuhet se përsëritet 100 ose 200 herë. Taberani si dua, nga Abdullah ibn Omer, që përsëritet 1000 herë. Zinxhirin e transmetuesve e ka të dobët.

¹⁶ Nuk është gjetur që përsëriten, por te Muslimi, nga Ajshe r.anha, thuhet se Resulallahu, s.a.v.s., i thoshte në ruku dhe sexhde. Tashmë është përmendur. Ebu Shejh në *el-Sevab*, nga Berra, si vijon: “*I Lavdëruar qoftë Sundimtari i Shejtë, Rabb i melekëve dhe Xhebrailit.*”

5. Estagfirul-lahel-adhimel-ledhi la ilahe ila huvel-hajjul-kajjumu ves'eluhut-tevde. (Kërkoj falje nga Allahu Teala, pos të Cilit nuk ka tjetër zot. Ai është i Gjalli dhe i Përherhemi, dhe te Ai pendohem).¹⁸

6. Allahumme la mani'a lima e'atajte ve la mu'tije lima mena'te ve la jenfe'u dhel-xheddi minkel-xheddu. (Rabbi im, askush nuk mund ta ndalë atë që Ti e dhuron, dhe askush nuk mund të japë atë që Ti e ndalon, dhe sundimtarit pushteti nuk i ndihmon kundër Teje).¹⁹

7. La ilahe ilallahul-melikul-hakkul-mubin. (Nuk ka zot tjetër përpos Allahut, Sunduesit të drejtë e të vërtetë).²⁰

¹⁷ Buhari dhe Muslim nga Ebu Hurejre, se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë: "Ai që brenda një dite e thotë këtë fjali njëqind herë, do t'i fshihen gjynahet, qofshin edhe sa shkuma e detit."

¹⁸ Mustagfiri në *el-Deavat*, nga Muadh b. Xhebel, që Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë: "Kush e përsëritë këtë 3 herë pas sabahut, dhe 3pas ikindisë, i falen gjynahet edhe nëse janë sa shkuma e detit." Fjalët: "te Ai pendohem" nuk kanë bazë të fortë, i përcjellë Tirmidhi, nga Ebu Seid, e përsëriten 3 herë. Buhari nga Ebu Hurejre: "Unë kërkoj falje nga Allahu, dhe pendohem te Ai më shumë se 70 herë në ditë." Taberani dhe Muslim nga E'rab: "Unë kërkoj falje nga Allahu nga 100 herë për çdo ditë." Janë përmendur në kapitullin 2 të *Librit për dhikret*.

¹⁹ Nuk është gjetur se përsëriten. Përmenden te namazi dhe ngritja nga rukuja. Buhari dhe Muslim e konsiderojnë të besueshëm.

²⁰ Mustagfiri në *el-Deavat* dhe Hatibi në *el-Ruvatan Malik* nga Alia r.a., që Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë: "Kush e përsëritë këtë fjali 100 herë gjatë një dite, shpëtojn nga varfëria dhe vuajtjet e varrit, fiton pasuri dhe i afrohet portës së xhennetit." Lidhje e dobët në hadith është Fadl b. Fanim. Ebu Nuajm në *el-Hilje* që Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë: "Kush e përsëritë këtë fjali 200 herë gjatë një dite dhe nate, Allahu Teala i jep çfarëdo që kërkon." Lidhje e dobët është Selim Havas. Mendohet se e transmeton Alia, r.a..

8. Bismil-lahil-ledhi la jedurru me'asmihi shej'un fil-erdi ve la fis-sema'i ve huves-semi'ul-alim. (Në emër të Allahut, pranë emrit të Tij asgjë nuk mund të dëmtojë, në qiej, as në Tokë. Ai është që dëgjon dhe di gjithçka).²¹

9. Allahumme Sali ala Muhammedin abdike ve nebijjike ve resuliken-nebijjil-umijji ve ala alihi ve sahibih i ve sellim. (Rabbi im, bekoje Muhammedin, s.a.v.s., robi Yt, pejgamber dhe i Dërguar, që nuk dinte të lexojë as të shkruajë, familjen e tij dhe as'habët).²²

10. E'udhu bil-lahis-semi'il-alimi minesh-shejtanir-raxhim. Rabbi e'udhu bik min hemezatih-shejtani ve e'udhu bike rabbi en jahdurun. (Kërkoj strehim te Allahu Teala, i Cili dëgjon dhe di gjithçka nga shejtani i mallkuar. Te Ti, o Rabb, kërkoj strehim nga cytja e shejtanit në të keqe, dhe nga prania e tij).²³

²¹ Autorët e Sunen, Ebu Davud, Tirmidhi, Nesai në *el-Kubra*, Bejheki, Ibn Hibban dhe Hakimi, nga Osmani r.a., se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë: "Kush e përsëritë 3 herë kur bie terri, nuk i ndodhë asnjë e keqe deri në agim, e kush e përsëritë 3 herë kur agon, nuk i ndodhë asgjë e keqe deri të errësohet." Tirmidhi e quan sahih hasen-garib.

²² Ebu Kasim Muhammed b. Abdulvahid Gafiki në *Fedailul-Kur'an*, nga Ibn Ebu Evfi, që Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë: "Kush dëshiron të pushojë në Qiellin e katërt, le t'i përsërisë për çdo ditë nga 3 herë këto fjalë." Në hadithin për vlerën e përsëritjes së tyre në mëngjes e mbrëmje nuk precizohet ky formulim. Taberani transmeton nga Ebu Derda që Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë: "Kush më dërgon salavat mua nga 10 herë, sa herë që të nis dita dhe të bie nata, do ta ketë shëfatin tim në ditën e Gjykimit." Zinxhiri është i këputur.

²³ Tirmidhi nga Ma'kil bin Jesar tregon se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë: "Kush thotë 3 herë kur të bëhet dritë: 'Kërkoj strehim te Allahu i Cili dëgjon dhe di gjithçka nga shejtani i mallkuar' dhe i lexon tri ajetet e fundit të sures Hashr, Allahu do ta mbrojë me 70,000 melekë..., dhe kush e përsëritë të njëjtën kur të errësohet, do të ketë derexhe të njëjtë." Ibn Ebu Dunja, nga Enes b. Malik tregon

Këto janë ato 10 fjali. Kur secila prej tyre lexohet nga 10 herë arrihet numri 100, e kjo ka më shumë vlerë se të lexohet vetëm njëra nga to 100 herë, për shkak që secila ka vlerë të veçantë. Me secilën, zemra përjeton kënaqësi dhe zgjohet, e kalimi nga njëra tek tjetra e mbronë shpirtin nga mërzitja.

LEXIMI I KUR'ANIT

Është e lavdërueshme (*mustehab*) të lexohen ajetet për vlerën e të cilave flasin hadithet e Resulallahut, s.a.v.s., siç janë:

- Ajetet e sures *Fatiha*²⁴,
- *Ajetul-kursijj*²⁵, (2-Bekare: 285),

se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë: *“Kush i përsëritë këto fjalë 10 herë kur të nis dita, do të jetë i mbrojtur nga shejtani deri në mëngjesin tjetër.”* Ebu Shejh në veprën es-Sevab nga Ajshe r.anha, transmeton se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë: *“A dëshiron të të mësoj, o Haid, fjalë që do t’i thuash 3 herë: thuaj: ‘Kërkoj strehim te Allahu Teala, me fjalët e përsosura, nga zemërimi i Tij, dënimit të Tij dhe robëve të këqij të Tij, nga cytja e shejtanit për të keqe dhe nga prania e tij.”* Është edhe transmetimi i Ebu Davud, Tirmidhiut dhe Hakimit nga Abdullah b. Amr ku thuhet se përmenden kur ndodhin ngjarje të tmerrshme, por nuk përsëriten.

²⁴ Buhari, nga Ebu Seid d. Muall, se kjo është surja më e vlefshme e Kur’anit. Muslimi nga Ibn Abbas që Allahu Teala i tha Resulallahut, s.a.v.s.: *“Tregoje lajmin e gëzuar për dy drita, që nuk i janë dhënë asnjë peygamberi tjetër: sure Fatiha dhe ajetet e fundit të Bekares, nga të cilat nuk do të lexosh një harf, e Unë të mos përgjigjem.”*

²⁵ Muslimi nga Ebu b. Ka’b që Resulallahu, s.a.v.s., i tha:

- *O Ebu Munzira, a e di cili ajet është më i vlefshmi?*, e Ka’b i tha:
- *Nuk ka zot përpos Allahut, të Gjallit, të Përvetshmit.*

- *Amenerrresulu* - dy ajetet e fundit (285 e 286) të sures *Bekare*²⁶,
- Ajeti i tetëmbëdhjetë i sures *Ali Imran*²⁷,
- Ajetet 26 dhe 27 të sures *Ali Imran*²⁸,
- Ajetet 128 dhe 129 të sures *Teube*²⁹,

Buhari transmeton nga Ebu Hurejre se kishte qenë i ngarkuar të ruajë hurmet e dhëna për sadaka, e i erdh shejtani dhe i tha:

- *Kur shkon në gjumë, lexo Ajetul-kursijj, e Allahu të jep një mbrojtës...*; Në hadith shkruan se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë: *“Të vërtetën ta ka treguar, ani pse është gënjeshtar.”*

²⁶ Muttefekun alejhi, Buhari dhe Muslim nga Ibn Mesud që Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë: *“Kush i lexon dy ajetet e sures Bekare gjatë natës, kjo do t’i mjaftojë (si mbrojtje).”*

²⁷ Ebu Shejh nes-Sevab nga Ibn Mesud që Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë: *“Kush e lexon ajetin ‘Allahu dëshmon...’, besimi i pranuar te Allahu, vërtetë është Islami”,* dhe thotë: *“Edhe unë dëshmoj atë që e dëshmon Allahu Teala, dhe Atij ia besoj këtë dëshmi, që është hise e imja te Ai”,* kjo i paraqitet në ditën e Gjykimit, e i thuhet: *“Ky rob i Imi më ka obliguar, e Unë jam i Pari në plotësim të obligimeve. Futeni robin Tim në xhennet.”* Për këtë Omer b. Muhtar i përcjellë disa gënjeshtër, nga Ibn Addijj, për çka do të flitet më vonë.

²⁸ Mustagfiri në *el-Deavat* nga Alia r.a., që Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë: *“Fatiha, ajetul-kursijj, ajeti ‘Allahu Teala dëshmon... besimi i pranuar te Allahu, vërtetë është Islami’ dhe ajeti ‘Thuaj: Allahu im! Ti e ke gjithë pushtetin!... Ti furnizon këtë të duash, pa kurrfarë llogarie!’, janë të shpalosur, dhe mes tyre e Allahut nuk ka kurrfarë perde; Allahu Teala do të shpërblejë me xhennet secilin rob të Tij që në fund të namazit i lexon ato...”* Në zinxhirin e transmetuesve është edhe Haris Umejr, ndërsa Ibn Hibban në *el-Duafa* thotë se është pa prova e pa bazë, dhe që Harisi transmeton hadithe të tilla. Të besueshëm e konsiderojnë Hammad b. Zejd, Ibn Mein, Ebu Hatim dhe Nesai, e Buhari përcjellë edhe komentimin.

²⁹ Taberani në *el-Dua* (me zinxhir të dobët) që Enes b. Malik ka thënë: *“Resulallahu, s.a.v.s., më mësoi atë që më mbron nga shejtani i mallkuar dhe nga sundimtari i keq.”*; dhe e përmend hadithin: *“...dhe thuaj: më mjafton Allahu Teala.”* Ebu Kasim Gafiki

- Ajetet 27, 28 dhe 29 të sures *Feth*³⁰,
- Ajeti 111 i sures *Isra*³¹,
- Pesë ajetet e para të sures *Hadid*³²; dhe:
- Tri ajetet e fundit të sures *Hashr*³³.

Nëse i lexon *Musebbiati ashere* që Hizri a.s., ia mësoi Ibrahim Tejmisë, dhe e këshilloi t'i lexojë në mëngjes e mbrëmje, do ta arrijë vlerën dhe meritat sikur të kishte lexuar të gjitha duatë e përmendura. Transmetohet se Kurrez b. Vebr, (Rahmetullahi alejh) që ishte sufi dhe ebdall, ka treguar se një herë e vizitoi një vëlla nga Shami, i solli një dhuratë, e ky e pyeti:

- *O vëlla, e ty kush t'a dhuroi këtë?*, e ai i tha:
- *Ma ka dhënë Ibrahim Tejmi.* Vebr përsëri e pyeti:
- *A e ke pyetur nga kush ai e ka marrë dhuratë?*
- *Po, i tha personi - e kam pyetur, e më pat thënë:*

në *Fedailul-Kur'an fi regaibil-Kur'an* të Abdulmelik b. Habib nga Muhamed b. Bekkar, se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë: "*Kush lexon 'Ju erdhi i Dërguari...' , nuk vdes nga dora e tjetrit, as nga fundosja, as në fatkeqësi as nga goditja me çelik.*" Transmetimi është i dobët.

³⁰ Nuk është gjetur hadith për këto ajete. Për vlerën e sures *Feth*, Ebu Shejh nga Ebu b. Ka'b, që Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë: "*Kush e lexon suren Feth, sikur të ketë qenë pjesëmarrës në marrjen e Mekes bashkë me Resulallahun, s.a.v.s.*" Hadithi është pa prova.

³¹ Ahmedi dhe Taberani nga Enesi që Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë: "*Ajeti i fuqisë, reputacionit dhe pozitës së lartë është: 'i Lavdëruar qoftë Allahu Teala, i Cili nuk ka fëmijë...'.*" Zinxhiri është i dobët.

³² Ebu Kasim Gafiki në *Fedailul-Kur'an* nga Alia r.a., që Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë: "*Kur dëshironi ta lutni Allahun Teala për diçka, lexoni pesë ajetet e para të sures Hadid dhe pesë ajetet e fundit të sures Hashr, e më pas lavdërojeni, pastaj bëni dua për atë që doni.*"

³³ Tirmidhi nga Ma'kil bin Jesar. Tashmë është përmendur. Bejheki në *el-Ba's* nga Ebu Umame: "*Kush e lexon pjesën e fundit të sures Hashr, natën ose ditën, e vdes atë natë ose atë ditë, Allahu Teala do ta shpërblejë me xhennet.*" Zinxhiri është i dobët.

...isha ulur në një qoshe të Qabesë e po bëja dhikr, kur m'u afrua një person, dha selam e u ul në anën time të djathtë. Kurrë në jetë nuk kam hasë person më të bukur, as rroba më të bukura, as aso bardhësie, e as aso arome. E pyeta:

- O rob i Allahut, kush je ti dhe prej nga vjen?

- Jam Hizri, më tha.

- Pse erdhe te unë?, e pyeta, e ai tha:

- Erdha të jap selam nga dashuria që kam për ty në emër të Allahut Teala, dhe e kam edhe një dhuratë që dua të ta jap. Unë e pyeta:

- E çfarë është ajo?, e më tha:

- Para lindjes së Diellit e t'i shtrijë rrezet e tij në sipërfaqen e Tokës, dhe para se të perëndojë Dielli, lexo suret *Fatiha*, *Nas*, *Felek*, *Ihlas* dhe *Kafirun*, si edhe *Ajetul-kursijj*; nga shtatë herë, më pas thuaj shtatë herë:

"I Lartësuar qoftë Allahu Teala. Hamd i takon vetëm Atij. Nuk ka zot pos Allahut, Allahu është Madhështori." Pas kësaj shtatë herë dërgoi salavat *Resulallahut*, s.a.v.s.. Pastaj shtatë herë kërko falje nga Allahu Teala, për vete, prindërit dhe të gjithë besimtarët e besimtare. Në fund shtatë herë thuaj: **"Rabbi im, na bëj në besim të atillë që, në këtë botë dhe në tjetrën, tash e në të ardhmen, Ti të jesh i kënaqur me neve, dhe Rabbi im, mos na bëj të atillë siç na përshtatet neve. Ti je Ai që falë shumë, je Mëshiruesi Fisnik."** Mos e braktis këtë lexim, në mëngjes, as mbrëmje.

- Kisha dashtë të më tregosh kush ta dha ty këtë dhuratë kaq me vlerë; i thashë unë, e më tha:

- Ma ka dhënë Muhammedi, s.a.v.s.. Unë i thashë:

- Më trego për shpërblimin e kësaj; e ai më tha:

- *Kur e takon Muhammedin, a.s., pyete, e të tregon.*

Tutje, Ibrahim Tejmi ka treguar se atë ditë në ëndërr i kanë ardhur melekët dhe e kanë marrë me vetenë xhennet. Atje ka parë nimete, që më pas edhe i ka përshkruar. Pastaj tregoi që, në një moment i pyet melekët se kujt i takojnë ato, e ata i përgjigjen:

- *Atij që vepron sikur ti.* Ibrahim Tejmi tregon se ka ngrënë e pirë në xhennet, e më pas i vjen Resulallahu, s.a.v.s., me 70 pejgamberë dhe me 70 safe me melekë, që shtrihej nga lindja në perëndim. Resulallahu, s.a.v.s., i dha selam, e mori për dore, e ky i tha:

- *O Resulallah, Hizri tha se këto i ka dëgjuar prej teje;* e Resulallahu, s.a.v.s., i tha:

- ***Të vërtetën e ka thënë Hizri, fjalët të tij janë hakikat. Hizri është dijetari i banorëve të dynjasë. Është i pari mes ebdallëve. Ai është ushtar i Allahut në dynja.*** Ibrahim Tejmi e pyeti:

- *O Resulallah, a fiton nga këto nimete edhe ai që i lexon këto vazhdimisht si unë, por nuk e sheh në ëndërr atë që unë e pashë?;* e Resulallahu, s.a.v.s., i tha:

- ***Pasha Atë i Cili më ka dërguar si pejgamber të vërtetë. Allahu do ta shpërblejë atë që është i qëndrueshëm në këtë lexim, edhe nëse nuk më sheh mua, as xhennetin. Allahu do t'ia falë të gjitha gjynahet dhe do të largojë nga ai sëmundjen e zemërimit dhe urrejtjen. Do ta urdhërojë melekun në anën e tij të majtë të mos i shënojë veprat e tij të këqija, për një vit. Pasha Atë i Cili më ka dërguar si pejgamber të vërtetë, kësaj do t'i përmbahen vetëm ata që janë të bekuar e do ta braktisin ata që mund bëjnë çdo gjynah.***

Ibrahim Tejmi i kaloi katër muaj pa ushqim e pije. Është e mundur që kjo të ketë ndodhur pas kësaj ëndrre.

Këtë e nënkupton obligimi i leximit të Kur'anit. Nëse personi i shton kësaj edhe diçka tjetër që merr nga Kur'ani, i shkruhet si mirësi. E mirësi i shkruhet edhe nëse qëndron vetëm në Kur'an, meqenëse Kur'ani në vete i përmbledhë vlerat e dhikrit, duave dhe tefekurit, pa marrë parasysh sa me kujdes lexohet, e për vlerën dhe rregullat e tij folëm në *Librin e leximit të Kur'anit*.

TEFEKKUR

Tefekkur (të menduarit) duhet të jetë një nga obligimet e besimtarit, e përshkrim më të detajuar se çfarë të mendojë dhe mënyrën si ta bëj, do të flasim në *Librin mbi të menduarit*.

Në përgjithësi, kjo përmbledhet në dy kategori:

1. Të mendojë për veprat që do t'i sjellin dobi ashtu që do të pranojë gabimet që i ka bërë, të përcaktojë obligimet e veta dhe të largohet nga ajo që e pengon në vepra të mira, duke i kujtuar gabimet dhe atë që i shkaktoi, e me qëllim që t'i përmirësojë dhe që në zemër të sjellë nijet për përmirësimin e vetes dhe për veprim në dobi të myslimanit;
dhe

2. Të mendojë për dituritë mukashefe që i sjellin dobi, e ky është mendimi për mirësitë (nimetet) e Allahut Teala dhe vazhdimësinë e bereqeteve të Tij, të dukshme e të padukshme, të shtohet dhe të forcohet marifeti, dhe të jetë më shumë falënderues ndaj Allahut. Për ta forcuar marifetin mendon për fuqinë dhe madhësinë e Allahut Teala, dhe që çdo krijesë i mbështetet Atij për çdo nevojë; për të shtuar frikën mendon mbi fatkeqësitë dhe dënimet. Secili prej këtyre ka shumë degë. Hollësitë do t'i shpjegojmë në librin *Tefekkur*. Kush hyn në këso lloj mendime le ta dijë që ky është ibadeti më i lartësuar, sepse *tefekuri*, përpos që paraqet përkujtimin e Allahut Teala, ai ka edhe dy elemente tjera:

1. Përforcimi i marifetit, sepse të menduarit është çelësi i *keshfit*³⁴ dhe marifetit; dhe

2. Shtimi i dashurisë, sepse zemra e do vetëm atë që meriton respekt.

Madhështia e Allahut Teala, cilësitë e Tij, fuqia dhe veprat e mahnitshme të Tij njihjen me *tefekkur*. Domethënë, nga *tefekuri* lind merifeti, nga marifeti lind respekti, e nga respekti lind dashuria.

Edhe dhikri lind afërsi, e edhe kjo është një lloj i dashurisë. Megjithatë, dashuria që lind nga marifeti është më e madhe, më e fortë dhe më e qëndrueshme,

³⁴ **Keshf:** hap; qelë; të dihet një gjë para se të ndodh; nxjerrja në shesh e një sekreti ose të fshehte; njoftim dhe dalja në shesh i një gjëje të fshehtë qysh më parë nga Allahu Teala me anë të dhënies së frymëzimit; vështrim me syrin e zemërës.

se sa dashuria që lind nga dhikri. Dallimi në mes të dashurisë së arifit dhe ndjenjave të ngjashme të atij që bën dhikr, pa tefekkur, është sikur dallimi në mes të dashurisë së atij që personalisht e njeh bukurinë e dikujt, moralin e bukur, veprat dhe cilësitë e atij personi, dhe ndjenjave të ngjashme të atij që përsëritë çfarë ka dëgjuar për dikë që nuk e ka parë, përmend moralin e bukur dhe pamjen në përgjithësi, pa e njohur atë bukuri në detaje. Dashuria e këso personi nuk është sikur dashuria e arifit, i cili në të gjitha këto të mira është bindur me sytë e vet, sepse nuk është njëjtë si të dëgjosh e si të shohësh. Robët e Allahut Teala që i janë dhënë dhikrit edhe me zemër edhe me gjuhë, dhe të cilët përmes imitimit besojnë në atë që e kanë sjellë pejgamberët, kur bëhet fjalë për cilësitë e Allahut Teala, posedojnë vetëm aq njohuri që e kanë dëgjuar nga të tjerët, e ju kanë besuar. Por arifët madhështinë dhe bukurinë e Allahut Teala e njohin me syrin e zemrës dhe me nurin e marifetit, e kjo është më e fortë se syri në ballë. Megjithëse, askush nuk ka mundur të njohë esencën e bukurisë dhe madhëstisë së Tij, sepse askush nga njerëzit nuk ka fuqi për këtë.

Secili shikon dhe sheh aq sa i ngritet perdja e vet. Këto perde që emërtohen *nur*, e që me arritjen e tyre personi mendon se e ka arrit esencën, janë shtatëdhjetë. Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

“Vërtetë Allahu Teala ka shtatëdhjetë perde prej nuri, e sikur t’i hiqte, shndëritja madhështore e fytyrës së Tij do të digjte gjithçka që arrinë.”³⁵

³⁵ Hadithi është përmendur kur kemi folur për themelet e besimit.

Këto prede janë me grada, e dritat dallojnë mes vete ashtu si dallojnë edhe Dielli, Hëna dhe yjet. Në perden e parë ka më pak nur, e që gradualisht shtohet. Sipas kësaj, disa sufi i kanë interpretuar gradat nëpër të cilat ka kaluar Ibrahim Halil a.s., në rrugën e ngritjes së tij, kur në Kur'an thuhet:

“E kur e mbuloi nata, ai e pa një yll...” 6-Enam: 76, pra, ka arritur deri te një perde nga drita, që e ka quajtur yll. Këtu nuk mendohet në trupa të ndriçueshëm qiellor. Disa njerëz e dinë se hyjnisë nuk i takon forma. Këtë e kuptojnë sapo të mendojnë pak, e ajo që nuk i mashtron njerëzit e rëndomtë nuk do ta mashtrojë as Ibrahimin, a.s.. Perdet që këtu quhen *dritë* (nur) nuk janë dritë që shihet me sytë tanë, por është drita për të cilën flasin edhe fjalët në vazhdim të Allahut Teala:

“Allahu është dritë i qiejve e i Tokës. Shembulli i dritës së Tij i gjason kandilit të vendosur në një zgavër të errët.” 24. Nur: 35

Por, t'i lëmë diskutimet për këto kuptime, sepse janë jashtë diturisë muamele. Te esenca e tyre arrihet vetëm me *keshf* të cilin e përcjellë mendimi i pastër, e pak janë të atillë që u janë hapur këto dyer. Ajo që është e arritshme dhe e mundur për njerëzit e rëndomtë është të menduarit për kuptimin e diturisë muamele, e kjo ka dobi të madhe.

Këto katër obligime: duaja, dhikri, leximi i Kur'anit dhe të menduarit, për atë që i dëshiron këto mirësi, duhet të jenë obligime jo vetëm pas namazit të sabahut por si pjesë e virdit pas secilit namaz të falur, sepse ky është obligimi i vetëm pas namazit. Që të jetë në

gjendje ta bëjë këtë, personi duhet të *armatoset* dhe të mbrohet, e agjërimi është mbrojtje që kufizon hapësirën e veprimit të shejtanit, i cili vazhdon të mundohet ta largojë njeriun nga rruga e drejtë. Pas zbardhjes së agimit, namazi i vetëm janë dy reقاتet e sunnetit të sabahut, si dhe farzi i sabahut që falet deri në lindjen e Diellit. Resulallahu, s.a.v.s., dhe as’habët e tij, këtë kohë e kalonin me dhikr.³⁶ Kjo edhe është më e mira, përpos nëse personin para farzit e kapon gjumi, dhe për të larguar gjumin mund të falë nafile.

Virdi i dytë ditor është koha prej lindjes së Diellit deri në namazin e duhasë (paradite). Nëse themi se dita zgjatë dymbëdhjetë orë, ky vird e mbulon një të katërtën e kësaj kohe, e që i përfshinë dy obligime shtesë:

Obligimi i parë është namazi i duhasë (namazi i paraditës), që e kemi shpjeguar në librin *Fshehtësitë e namazit*. Më e mira është që personi të falë dy reقاتe kur Dielli të ngritet për gjysmë shtize, pastaj katër, gjashtë ose tetë reقاتe falë kur dielli fillon të ngrohë këmbët, para dreke.

Koha për dy reقاتet e përmendura është ajo që e tregojnë fjalët e Allahut Teala:

“...bëjnë tesbihë Allahut, në mbrëmje dhe mëngjes.” 38-Sad: 18

³⁶ Tashmë është përmendur. Muslimi nga Xhabir b. Semur se Resulallahu, s.a.v.s., qëndronte ulur deri në lindje të Diellit, por nuk e përmend që këtë kohë e ka kaluar në dhikr. Ajo çfarë thotë tashmë është përmendur, nga Enesi, te Tirmidhi.

Kjo është koha e daljes së Diellit, kur drita e tij lajmërohet plotësisht, duke u ngritur nga avulli dhe pluhuri në sipërfaqen e Tokës (horizont) dhe që e pengon të duket plotësisht. Koha e faljes së katër reqateve është pjesa më e mirë e mëngjesit, me të cilën edhe Allahu Teala betohet:

“Pasha paraditën! Pasha natën kur shtrinë errësirën!” 93-Duha: 1, 2.

Resulallahu, s.a.v.s., erdhi mes as’habëve kur lindi Dielli dhe i gjeti në namaz, e tha me zë të lartë:

“Kujdes! Namazi i njerëzve të mirë është koha e paraditës, kur këlyshët e devesë gulçojnë nga vapa, e pushojnë.”³⁷

Në bazë të kësaj përfundojmë se kjo nuk është koha më e mirë për namazin duha për atë i cili falë namaz vetëm një herë; në këtë interval, më mirë është që namazin ta lë për më vonë. Sevapi në esencë fitohet nëse falet duke filluar nga momenti kur Dielli të largohet nga horizonti për një gjatësi afërsisht të gjysëm shtize, e deri para mesditës, kur Dielli të jetë në zenit. I gjithë ky interval kohor quhet *ed-duha*.

Dy reqartet e namazit duha mund të falen prej momentit kur lejohet të falet namazi, pra kur përfundon koha në të cilën është e papëlqyer të falet namaz. Në lidhje me këtë, Resulallahu, s.a.v.s, thotë:

“Brirët e shejtanit dalin bashkë me Diellin, e kur dielli ngritet, ai largohet.”³⁸

³⁷ Taberani, nga Zejd b. Erkam.

Më së paku, Dielli duhet të ngritet përmbi avullin e Tokës dhe pluhurit të horizontit, në lartësi që caktohet për afërsisht;

Obligimi i dytë është në raport me të tjerët, që praktikohen qysh me mëngjes, siç është vizita të sëmurit, përcjellja e xhenazes, ndihma në mirësi dhe takvallëk, pjesëmarrje në tubime të diturisë dhe në tubime për zgjidhjen e nevojave të myslimanëve, e të tjera. Nëse nuk ka rast për asgjë nga këto, atëherë i ka katër obligimet për të cilat folëm: duatë, dhikrin, leximin e Kur'anit, tefekkur e namaz, që është i papëlqyer (*mekruh*) pas namazit të sabahut deri në lindjen e Diellit, por nuk është pas namazit duha. Namazi bëhet veprimi i pestë në kuadër të obligimeve të kësaj kohe. Pas farzit të sabahut e deri në lindjen e Diellit, është i papëlqyer secili namaz që nuk e ka arsyen³⁹. Më së miri është që para farzit të mjaftohet me dy reqate të sunnetit të sabahut dhe dy reqate të *tehijjetul-mesxhid*, e pas kësaj t'i kushtohet dhikrit, mësimi të Kur'anit, duasë dhe meditimit (*tefekkur*).

Virdi i tretë ditor nënkupton kohën nga mesi i paradites, deri 45 minuta para namazit të drekës, pra mesi i paradites është tri orë pas lindjes së Diellit. Më e pëlqyeshme është të falet namaz në fillim të çdo ore. Por kur kalon tri orë, falet namazi duha. Nëse themi se dita zgjatë dymbëdhjetë orë, tri orë pas kësaj e kemi namazin e drekës. Tri orë më pas është ikindia, e

³⁸ Hadithi është përmendur në librin për namazin.

³⁹ Namaz që e ka arsyen është për shembull *tehijjetul-mesxhid*, arsye e të cilit është hyrja në xhami.

akshami pas tri orëve tjera. Koha e duha-namazit është në mes të lindjes së Diellit dhe pasdites njëjtë si koha e ikindisë që është në mes të mesditës dhe perëndimit të Diellit. Megjithatë, duha-namazi nuk është i obligueshëm, si lehtësim për njerëzit, sepse kjo është koha kur njerëzit angazhohen për fitim dhe sigurim të jetesës dhe i kryejnë punët e veta. Për këtë kohë, krahas katër obligimeve që i përmendëm, janë edhe dy tjera:

1. Shkuarja në çarshi dhe në pazar, dhe angazhimi për fitim dhe sigurimin e kushteve të jetesës. Nëse është tregtar, duhet bërë tregti me nder dhe me mëshirë. Në të gjitha punët njeriu duhet ta përkujtojë Allahun, e në punët e dynjasë të mjaftohet vetëm me atë që i duhet për atë ditë. Kur të sigurojnë atë që ju duhet për atë ditë, njerëzit duhet të shkojnë në xhami ose kthehen në shtëpi e të përgatiten për ahiret. Nevoja për furnizimin për ahiret është më e madhe, e fitimi për ahiret është në vazhdimësi. Furnizimi për ahiret është më e rëndësishme se sa kërkimi i asaj që për momentin nuk na duhet. Në këtë kuptim, është thënë: *“Besimtari është në një prej tri vendeve: në xhami - për ibadet, në shtëpi - që i mbronë, ose në kërkim të plotësimin të nevojave të tyre të domosdoshme.”*

Pak ka prej atyre që e dinë cilat janë këto *nevoja të domosdoshme*. Shumica e njerëzve e konsiderojnë të domosdoshme atë që, në fakt as nuk ju duhet, sepse shejtani i frikëson me fukarallëk dhe ju urdhëron teprimin, e ata e dëgjojnë, prandaj edhe grumbullojnë atë që nuk do ta hanë, vetëm nga frika prej fukarallëkut. Nga ana tjetër, Allahu Teala ju premtan falje dhe rahmet, e ata nuk e dojnë dhe heqin dorë nga kjo;

2. Gjumi ditor, quhet *kajlule*, dhe është pushimi para ose pas drekës, e na ndihmon që natën ta kalojmë në namaz, siç ndihmon syfyri që ditën ta kalojmë duke agjëruar. Nëse personi nuk e kalon natën në namaz, por as nuk flen ditën dhe nuk merret me asgjë që është e mirë, por, ndoshta, shoqërohet me të panjohur e flet me ta thashetheme dhe, nëse veprimet e tij nuk kanë të bëjnë me dhikr dhe me obligimet tjera fetare që i përmendëm, në atë rast gjumi është zgjedhje më e mirë, sepse nënkupton heshtje dhe shpëtim. Dikush ka thënë: *“Do të vijë një kohë kur ibadeti më i pëlqyeshëm i njerëzve të asaj kohe do të jetë gjumi dhe heshtja.”*

Këtë kohë njerëzit janë të pasinqertë në ibadet dhe dyfyturësh. Sa ka abidë që veprimi i tyre më i pëlqyeshëm është gjumi. Nëse për abidin gjumi është më i pëlqyeshëm, atëherë ashiqare që për të padijshmin e pabesimtarin gjumi është edhe më i pëlqyeshëm. Sufjan Sevri ka thënë: *“Gjeneratës së parë (selefi salihin) ju pëlqente që, kur nuk kishin ndonjë obligim, të bëjnë gjumë, në kërkim të qetësisë dhe shpëtimit.”*

Nëse gjumi bëhet me këtë qëllim, dhe me qëllimin që nata të kalohet në namaz, ai gjumë i llogaritet ibadet.

Por, duhet të zgjohet para ezanit të sabahut, bëhet gati për namaz, merr abdes e shkon në xhami para kohës së namazit. Këto janë veprime të vlefshme. E nëse nuk fle as nuk punon por është në namaz e dhikr, atëherë këto i ka veprimet më të vlefshme të ditës, sepse kjo është koha kur njerëzit e lënë anash dhe e harrojnë Allahun Teala, e angazhohen në punë të dynjasë. Zemra që i kushtohet Rabbit të vet në kohën kur njerëzit e harrojnë Atë, e meriton që Allahu Teala ta

pastrojë dhe shpërblejë edhe për njohjen e Tij. Vlera e kësaj është sikur vlera e qëndrimit pa gjumë natën, sepse nata është kohë kur Allahu Teala harrohet e lihet anash për shkak të gjumit, e dita është koha kur Ai harrohet e lihet anash për shkak të dëshirës dhe punëve të dynjasë. Në lidhje me këtë, Allahu Teala thotë:

“ Ai, krijoi natën dhe ditën që të vijjnë njëra pas tjetrës, këshillë për ta që duan ta kujtojnë (Allahun), ose ta falenderojnë (Atë).” 5-Furkan: 62.

Një nga kuptimet që mund të nxjerret nga ky ajet është edhe që nata me ditën e pasojnë njëra-tjetrën, në vlerë dhe në kuptim. Kuptimi i dytë do të ishte që njëra e pason tjetrën, me qëllim që të kompenzohet ajo që është lëshuar në kohën paraprake.

Virdi i katërt ditor është prej drekës deri në përfundimin e dy reqateve të sunnetit. Ky është virdi më i shkurtë dhe më i vlefshëm i ditës. Kur merr abdes para mesditës, shkon në xhami e muezini fillon me ezan, le të presë deri në fund të ezanit, e pastaj të ngritet që të falë katër reqate sunnet deri në ikamet, meqenëse kjo është koha e mesditës për të cilën flet Allahu Teala në fjalët:

“...dhe në mesditë .” 30-Rum: 18.

Le të falë katër reqate që nuk i ndanë me selam. Ky është namazi i vetëm ditor për të cilin transmetohet se Resulallahu, s.a.v.s., e falte me një selam. Por, ky transmetim ka kritika. Imam Shafi i falte nga dy, si nafilet tjera, e i ndante me një selam. Për këtë flasin transmetime të besueshme.⁴⁰

⁴⁰ Ebu Davudi dhe Ibn Hibban nga Ibn Omeri, r.a..

Duhet t'i zgjasë këto katër reqate, sa të mundet, sepse në këtë kohë hapen dyert e xhennetit, siç tregon transmetimi i përmendur në pjesën për namazet nafile. Në këtë namaz duhet të lexojë suren *Bekare*, ose ndonjë tjetër sure me qindra ajete, ose të lexojë katër ajete, pasi që kjo është koha e ditës kur pranohen duatë, dhe që edhe vet Resulallahu, s.a.v.s., ka dëshiruar që në këtë kohë t'i ngriten veprat. Pas katër reqateve të përmendura, të gjatë ose të shkurtë, që nuk duhet t'i lëshojë, e falë me xhemat namazin e drekës.

Pas namazit të drekës, i falë dy pastaj katër reqate, meqenëse Ibn Mesud nuk e pëlqente që pas katër reqateve farz të pasojnë po aq nafile, pa pushim. Prandaj, pas farzit i falë dy e më pas katër reqate. Është e lavdëruar dhe rekomanduar, që në këto reqate të lexojë *Ajetul-kursijj*, ajetet e fundit të sures *Bekare*, si edhe ajetet që i përmendëm për virdin e parë, që kështu t'i bashkojë duanë, dhikrin, leximin e Kur'anit, salavatin, hamdin (falënderimin) dhe tesbihun me vlerën e asaj kohe.

Virdi i pestë ditor ndërlihet me të katërtin dhe zgjatë deri në namazin e ikindisë. Është e lavdërueshme që në këtë kohë të tërhiqet në xhami, t'i kushtohet dhikrit, namazit ose ndonjë veprë tjetër të mirë, dhe kështu ta kalojë kohën deri në namazin e radhës, sepse një nga veprimet e mira është edhe pritja e një namazi pas tjetrit. Kështu vepronin gjeneratat e para. Bile, kush hynte në xhami mes drekës dhe ikindisë, i dëgjonte tingujt e leximit të Kur'anit sikur gumëzhima e bletëve.

Nëse të gjithë anëtarët e familjes janë myslimanë, dhe të gjithë e kanë nijet që këtë kohë ta kalojnë në një ibatet të njëjtë nga këto që i përmendëm, atëherë më mirë është këtë kohë ta kalojnë në shtëpi. Koha e këtij viridi, që gjithashtu është kohë kur njerëzit e harrojnë dhe anashkalojnë mendimin për Allahun, kalohet sikur koha e viridit të tretë. Në këtë kohë është e papëlqyer të flehet, për atë që ka fjetur para mesditës, meqenëse është mekruh të flihet dy herë gjatë një dite. Disa dijetarë thonë: *“Allahu Teala i urren tri gjëra, të qeshurit pa arsye, ngrënien e atij që nuk ka uri, dhe fjetjen gjatë ditës pa u ngritë për ibdetin e natës.”*

Sa për fjetjen, duhet ditur që nata dhe dita zgjasin njëzet e katër orë, prej të cilave mesatarja e nevojshme është të kalohen tetë orë në gjumë, në total. Nëse fle kaq gjatë natës, atëherë nuk ka kuptim të flejë edhe ditën. E nëse nuk fle tetë orë gjatë natës, atëherë do ta kompenzojë gjatë ditës. Pra, nëse njeriu jeton gjashtëdhjetë vite, në gjumë i kalojnë njëzet vite; nëse fle tetë orë, që është një e treta e ditës, do të thotë që në gjumë i kalon një e treta e jetës. Por, pasi që gjumi është ushqim për shpirtin njëjtë siç është gjella për trupin, ndërsa dituria e dhikri janë ushqim të zemrës, atëherë njeriu nuk mund t'i ndërpresë këto. Shkurtimi i kohës së cekur prej tetë orësh për gjumë, mund të shkaktojë çrregullime trupore, përpos te ai që, duke ushtruar, gradualisht është mësuar pa gjumë, e pa ndonjë çrregullim. Ky virid është nga më të gjatët, dhe që ofrojnë më së shumti kënaqësi.

Kjo është një nga kohët që Allahu e përmend në Kur'an:

“Allahut i bëjnë sexhde të gjithë ata që gjenden në qiej dhe në Tokë, dashtë e padashtë, si dhe hijet e tyre (i bëjnë sexhde), në mëngjes dhe në mbrëmje.”

13-Rad: 15

Nëse Allahut Teala sexhde i bën edhe ajo çfarë është jo e gjallë, si atëherë robët e Tij mund të mospërfillin obligimet fetare?!

Virdi i gjashtë ditor fillon kur të hyjmë në kohën e namazit të ikindisë, e kjo është koha me të cilën Allahu Teala betohet në Kur'an:

“Pasha kohën!” 103-Asr: 1.

Ky është një nga dy kuptimet e këtij ajeti, me të cilin, sipas një interpretimi, nënkuptohet koha para mbrëmjes, që përmendet edhe në ajetin Kur'anor:

“Dhe ai doli prej faltores para popullit të vet dhe ju dha shenjë: *Adhuroni Allahun, mëngjes e mbrëmje.*”
19-Merjem: 11, ose:

“Ne ia nënshtruam atij bjeshkët, që bashkë t'i bëjnë tesbihë Allahut, në mbrëmje dhe mëngjes.”

38-Sad: 18

Namazi i vetëm në kuadër të këtij virdi janë katër reqate në mes të ezanit dhe ikametit, sikur te rasti i namazit të drekës. Pastaj falet farzi i ikindisë, e pas kësaj i kushtohemi ibadeteve që i përmendëm për virdin e parë, deri sa Dielli të arrijë te horizonte e të marrë ngjyrë të verdhë. Pasi që kjo është kohë kur namazi është i ndaluar, më së miri e ka të lexojë Kur'an duke

provuar ta kuptojë, për shkak që kjo bashkon në vete edhe dhikrin, edhe duanë, edhe tefekkur, respektivisht pjesën më të madhe të qëllimeve të këtyre tri ibadeteve.

Virdi i shtatë ditor nis kur Dielli zverdhet, pra kur i afrohet horizontit, ashtu që drita e tij, ku vërehet ngjyrë e verdhë, ta mbulojë atë horizont. Siç shtrihet virdi i parë nga agimi deri në lindjen e Diellit, virdi i shtatë zgjatë deri në perëndimin e tij:

“Larësojeni Allahun kur bie muzgu dhe kur të agojë mëngjesi.” 30-Rum: 17, dhe:

“.. lavdëroje me falenderim Rabbën tënd para lindjes së diellit, dhe para perëndimit të tij...”

20-Ta’Ha: 130

Hasan Basriu ka thënë: “Gjenerata e parë *më shumë e vlerësonin fillimin e natës, se sa fillimin e ditës*”;

dhe ka thënë: “Disa nga gjenerata e parë fillimin e ditës ia kushtonin kësaj bote, e fundin e ditës, ahiretit.”

Prandaj është e lavdërueshme (*mustehab*) në këtë pjesë të ditës posaqërisht të bëj tesbih dhe istigfar, si edhe t’ju kushtohet ibadeteve tjera që i përmendëm te virdi i parë, siç janë edhe fjalët në vijim:

Estagfirul-lahel-ledhi la ilahe ila huvel-hajjul-kajjumu ves’eluhut-tevbete ve subhanallahil-adhimi ve bi hamdihi. (Kërkoj falje nga Allahu Teala, nuk ka zot tjetër pos Tij. Ai është i Gjalli e i Përhershmi, dhe Atë e lus të ma pranojë pendimin. I lavdëruar qoftë Allahu Teala dhe hamd i qoftë Atij). Fjalët janë marrë nga ajeti:

“...kërko falje për mëkatin tënd, lartësoje me falënderim Rabbën tënd mbrëmje e mëngjes.”

40-Gafir: 55

Kërkim falja me përmendje të emrave të bukur të Allahut Teala, e që i gjejmë në Kur'an, është mënyra më e mirë për të kërkuaar falje. Para perëndimit të Diellit është *mustehab* të lexohet: esh-Shems, el-Lejl, Felek dhe Nas, dhe në perëndim të Diellit të bëj istigfar. Pasi të dëgjojë ezanin, duhet të thotë:

Allahumme haza ikbalu lejlike ve idbaru neharike ve asvatu du'atike. (*Rabbi im, kjo është pritja e natës Tënde, përcjellja e ditës Tënde dhe zëri i atij që Ty të lutet*), më pas i përgjigjet muezinit e falë farzin e akshamit. Me perëndimin e Diellit përfundojnë virdet ditore, e njeriu duhet t'i kthehet gjendjes së vet e ta vlerësojë, meqenëse sapo përfundoi një fazë e jetës së tij. Nëse dita i ka kaluar sikur një ditë më herët, është mashtruar, e nëse ditën e sotme e ka më të keqe se dje, është i mallkuar, sepse Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

“Nuk jam i bekuar në ditën në të cilën nuk bëj më shumë të mira (se një ditë më herët).”⁴¹

Nëse konsiderohet që bën vepra të mira përgjatë gjithë ditës e i braktisë të këqijat, atëherë ky është lajm i mirë dhe ai duhet t'i falënderohet Allahut Teala, për ndihmën që Ai ia ka ofruar, dhe që e ka udhëzuar në atë rrugë. Në të kundërtën, duhet ta dijë që pas natës vjen ditë e re, ku mund t'i kompenzojë lëshimet nga dita e kaluar, sepse veprat e mira i shkatërrojnë të këqijat. Duhet ta falënderojë Allahun Teala për shëndetin që ia ka dhënë dhe për pjesën e mbetur të jetës në të cilën do të kompenzojë atë që i ka ikur.

⁴¹ Hadithi është përmendur në kapitullin 1 të *Librit për diturinë*, por aty thuhet “...mësoj më shumë”, në vend të “...bëj më shumë të mira.”

Duhet ta dijë se *dita e quajtur jetë* e ka edhe fundin e vet, kur edhe do të *perëndojë Dielli* i saj, e nuk do të lind më. Atëherë mbyllen dyert e përmirësimit dhe kërkim faljes. Jeta është vetëm një grumbull ditësh të cilave domosdo ju vjen fundi, njëjtë siç përfundon edhe një ditë e vetme.

EVRAZI I NATËS

Edhe këto janë pesë:

Virdi i parë i natës; është prej perëndimit të Diellit deri në kur të zhduket e kuqërremta në horizont, pra është mes akshamit dhe jacisë. Allahu Teala betohet në këtë kohë:

“Betohem në kuqërrimin e horizontit pas perëndimit.” 84–Inshikak: 16

Namazi në këtë kohë nënkupton fillimin e natës, e kjo është një nga kohët për të cilën në Kur’an thuhet:

“Lavdëroje Atë edhe në orët e natës.”

20-Ta Ha: 130

Është namaz i të penduarit (*evvabin*); për të Allahu Teala thotë:

“I heqin trupat e tyre prej dyshekëve.”

32-Sexhde: 16

Transmetohet nga Hasani, e ai nga Ibn Ebu Zijad, që Resulallahu, s.a.v.s., me një rast është pyetur për këtë ajet, e ka thënë:

- Është namazi mes akshamit e jacisë;

e në vazhdim Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Falni namazin mes akshamit dhe jacisë, sepse i shkatërron gjynahet e vogla të asaj dite, dhe e zbukuron fundin e saj.”

E pyetën Enesin r.a., a është xhaiz të flihet mes akshamit dhe jacisë, e Enesi tha:

- Jo, mos flej, sepse kjo është koha për të cilën Allahut Teala thotë:

“I heqin trupat e tyre prej dyshekëve”.

Për vlerën e ibadetit në këtë kohë do të flasim në kapitullin e dytë, ndërsa renditja përbrenda këtij virdi është si vijon: Pas namazit të akshamit i falë dy reqate ku lexon *Kafirun* dhe *Ihlas*, pa folë ose bërë diçka mes tyre. Më pas i falë katër reqate që i zgjatë, e më pas falë sa mundet, deri në zhdukjen e të kuqërremtës në horizont (pra, deri në jaci). Nëse xhaminë e ka afër, këto mundet t'i falë në shtëpi, pos nëse ka nijet të qëndrojë në xhami (*itikaf*). Nëse e ka bërë nijet të falë namaz në xhami deri në jaci dhe është i vetëdijshëm se nuk e bën për dukje, atëherë më mirë është të qëndrojë në xhami.

Virdi i dytë i natës; fillon me hyrjen e kohës së namazit të jacisë e vazhdon deri kur njerëzit të flejnë. Kjo është koha kur errësira e natës shtohet dhe me të cilën Allahu Teala betohet në Kur'an:

“Betohem në natën e në gjithçka që ajo kaplon me errësirën e saj.” 84-Inshikak: 17

Më pas, Allahu Teala thotë:

“Fale namazin kur zbret Dielli (nga zeniti), e deri në errësirën e natës.” 17-Isra: 78

Në atë kohë pra, errësira shtohet dhe nata bëhet shumë e errët. Ky vird nënkupton tri obligimet si vijon:

1. Kur falë farzin e jacisë, t'i falë edhe 10 reqate: 4 para farzit, në mes të ezanit dhe ikametit, dhe 6 pas farzit; një herë 2, pastaj 4. Me këtë rast duhet lexuar ajete të posaçme, siç janë ajetet e fundit të sures Bekare, Ajetul-kursijj, ajetet e para të sures Hadid, ajetet e fundit të sures Hashr, e të tjerë.

2. Të falë 13 reqate; namazin vitri e lë në fund meqë është transmetuar se Resulallahu, s.a.v.s., gjatë natës falte më së shumti kaq.⁴² I mençuri, ibadetin e natës i falë në fillim të natës. Ai që i beson vetes, do t'i falë kah fundi i natës, e më mirë është t'i falë më herët, sepse ndoshta nuk do të ngritet fare, ose do ta ketë të vështirë. Por nëse kështu është mësuar, atëherë më mirë ta falë më vonë. Në to duhet të lexojë 300 ajete nga suret prej të cilave edhe Resulallahu, s.a.v.s., ka lexuar shumë, siç janë: Ja Sin, Sexhde, Llukman, Duhan, Mulk, Zumer dhe Vakia.

Nëse nuk i falë reqatet, së paku le t'i lexojë këto sure, ose disa prej tyre, para gjumit, meqë tri hadhithet tregojnë se edhe Resulallahu, s.a.v.s., i ka lexuar për çdo natë. Më së shpeshti përmenden suret Sexhde, Mulk, Zumer dhe Vakia. Në një transmetim thuhet se për çdo natë i lexonte suret Zumer dhe Isra, e në transmetim tjetër që i lexonte suret Had, Hashir, Saf, Xhuma dhe Tegabun, dhe transmetohet se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë se në këto sure është një ajet më i vlefshëm se 1000 ajete. Lidhur me këtë, disa dijetarët kanë shtuar edhe suren Ala:

“Falendero emrin e Rabbit tënd të Lartësuar”

87-Ala: 1,

⁴² Ebu Davud, nga Ajshe, r.anha: “Resulallahu (a.s.), nuk falte më pak se 7 e më shumë se 13 reqate për një natë.” Buhariu, nga Abbasi r.a.: “Namazi i tij gjatë natës i kishte 13 reqate.” Muslimi: “I falte 13 reqate gjatë natës.” Te Buhari dhe Muslim: “...13 reqate, mes tyre edhe 2 reqatet e namazit të sabahut.” dhe: “As gjatë muajit të Ramazanit, e as jashtë tij, nuk i falte më shumë se 11 reqate gjatë një nate.”

meqenëse në një transmetim thuhet se Resulallahu, s.a.v.s., e donte shumë këtë ajet, dhe që në tri reقاتet e namazit vitri lexonte tri sure: Ala, (në reقاتin e parë) Kafirun (në reقاتin e dytë) dhe Ihlas (në reقاتin e tretë), e kur përfundonte namazin, tri herë i përsëriste fjalët:

Subhanel-melikil-kuddus (i Lavdëruar qoftë Rabbi i bekuar).

3. Namazi i vitrit; nëse nuk zgjohet më vonë natën duhet t'i falë para fjetjes. Ebu Hurejre, r.a., ka thënë: *“Resulallahu, s.a.v.s., më ka këshilluar të mos shkoj në gumë para se të fali namazin vitrit.”*

E nëse është mësuar të zgjohet më vonë, duhet ta dijë që shtyerja e namazit vitri deri në natën e vonë, është më mirë. Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

“Falni namazin e natës me nga dy reقاتe, e kur të afrohet agimi, false edhe një reقات vitri.”⁴³

Ajshe, r.anha, ka treguar: *“Resulallahu, s.a.v.s., falte namazin e vitrit në fillim të natës, në mes dhe në fund të saj, e me to përfundonte para agimit.”*

Alia, r.a., ka thënë: *“Namazi i vitrit falet në tri mënyra; mund ta falni në fillim të natës një reقات e më vonë vazhdon nga dy reقاتe; mund të falni një reقات të namazit vitri në fillim të natës, e kur të zgjoheni vazhdoni nga dy reقاتe, e nëse dëshironi mund të falni një reقات vitri në fund të natës. Cilën do që ta bëni është mirë. Por vitrin të braktiset nuk është e drejtë.”*⁴⁴

⁴³ Buhari dhe Muslim, nga Ibn Omeri, r.a..

⁴⁴ Sipas medh'hebit Hanefi namazi vitri është tri reقاتe, nuk ka namaz me një reقات.

Transmetohet se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:
“Nuk ka dy namaze vitri për një natë.”⁴⁵

Për ata që nuk janë të sigurt se do të ngriten, ka zgjedhje, të cilën disa dijetarë e konsiderojnë të mirë, e kjo është që para gjumit, ta falë një reقات e më pas dy reقاتe ulur, në shtrat. Resulallahu, s.a.v.s., shkante në shtrat dhe i falte këto dy reقاتe, dhe lexonte në to Zelzel (në reقاتin e parë) dhe Tekathur (në reقاتin e dytë), për shkak të paralajmërimit dhe kërcënimit që përmenden aty. Në transmetim tjetër thuhet se lexonte suren Kafirun, sepse në të veçohen robët e mirë të Allahut. E disa thonë se nëse personi ngritet pas kësaj, atëherë këto dy reقاتe që i falë ulur në shtrat i vlejné si një, prandaj në fund të namazit të natës nëse e falë edhe një reقات vitri, kjo në total bëhet numër qift, e sipas kësaj në fund e falë një reقات. Ebu Talib Mekkiut kjo i pëlqente, dhe thoshte: *“Kjo nënkupton tri gjëra të bukura, mos-shtyerjen e punëve, falje të namazit dhe faljen e vitrit në fund të natës.”*

Kjo kështu është, por ndoshta është e rrezikshme, nëse mbështetemi në supozimin se ato dy reقاتe përbëjnë numër çift kur i bashkohen reقاتit më herët, e nëse nuk ngritemi humb vitrin e parë. Është diskutabile të thuhet se është çift nëse ngritemi e tek nëse vazhdojmë në gjumë, pos nëse ka transmetim *sahih* që Resulallahu, s.a.v.s., e ka falur vitrin para atyre dy reقاتeve, e më pas edhe e ka përsëritur.

⁴⁵ Ebu Davud, Tirmidhi, si hasen dhe Nesai nga Talk b. Ali.

Nga kjo mund të përfundohet se këto dy reqate, me formën e tyre janë çift, e në esencë janë tek, respektivisht, nëse nuk zgjohet, konsiderohen vitri, e nëse zgjohet, konsiderohen dy. E pas selamit në fund të namazit vitri është e lavdërueshme të thuhet:

Subhanel-melikil-kuddusi rabbil-mela'iketi ver-ruh. Xheleltes-semavati vel-erda bil-azameti vel-xheberuti ve teazzezte bil-kudreti ve kahher-tel-ibade bil-mevt. (Lavdëruar qoftë Rabbi i shejtë, Rabb i melekëve dhe Xhebrailit. Ti i përfshinë edhe qiejt edhe Tokën me fuqinë dhe madhëstsinë Tënde. Ti je i Fuqishmi e Fuqiploti, dhe Ti i ndalon robët Tu me vdekjen).

Tregohet se Resulallahu, s.a.v.s., para vdekjes më së shumti falej ulur, përpos farzit⁴⁶, dhe ka thënë:

“Ai që falë namaz ulur, ka gjysmën e shpërblimit të atij që e falë në këmbë, e ai që e falë i shtrirë, ka gjysmën e shpërblimit të atij që e falë ulur.”⁴⁷

Kjo dëshmon që namazi nafile mund të falet në çfarëdo pozite.

Virdi i tretë i natës; është koha e gjumit. Edhe gjumi llogaritet vird, sepse është ibadet nëse i përmbahemi rregullave për atë gjendje. Kur njeriu fle i pastër (me abdes), dhe pasi ta përmend Allahun, konsiderohet që është në namaz, deri sa të zgjohet nga gjumi.

⁴⁶ Muttefekun alejhi, Buhari dhe Muslim nga Ajshe, r.anha: “Pasi që u plak e u dobësua, falte shumë namaz ulur.”

⁴⁷ Buhari, nga Imran b. Husejn.

Një melek futet në rrobat e tij dhe bën istigfar dhe dua për të, sa herë që ky të lëvizë në gjumë e të përmend Allahun.⁴⁸ Në transmetim thuhet:

“Kur personi të flejë i pastër (me abdes), shpirti i ngritet deri te Arshi.”⁴⁹

Kjo ka të bëjë me të gjithë, e si është me dijetarët dhe me ata që i kanë zemrat e pastra?! Atyre në gjumë ju shpalosen fshehtësi, prandaj Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Gjumi i dijetarit është ibadet, fryma e tij është tesbih.”⁵⁰

Muadhi e pyeti një herë Ebu Musanë se si i kalon netët, e Ebu Musa iu përgjigj:

- *Gjithë natën e kaloj në namaz, nuk flej fare dhe lexoj shumë Kur'an.* Atëherë, Muadhi tha:

- *Unë flej, pastaj edhe fali namaz, dhe e vlerësoj gjumin tim ashtu si e vlerësoj edhe ibadetin tim.*

Ebu Musa ia tregoi këtë Resulallahut, s.a.v.s., e ai tha:

- ***Muadhi është më i ditur se ti.***⁵¹

⁴⁸ Ibn Hibban, nga Ibn Omeri. “...meleku thotë: *Rabbi im, fale këtë rob tëndin, sepse ka fjetur i pastër.*”

⁴⁹ Ibn Mubarek në ‘*Zuhd*’, me zinxhir të këputur te Ebu Derda, Bejheki në ‘*Shuab’l-iman*’, me zinxhir të këputur te Abdullah b. Amr b. el-As, dhe Taberani në ‘*Evsat*’, nga Alia r.a..

⁵⁰ Është përmendur në *Librin për agjërimin*, ku thuhet *agjëruesi*.

⁵¹ Muttefekun alejhi, nga Ebu Musa, pa pjesën se i treguan Resulallahut s.a.v.s., dhe ai ka thënë se Muadhi është më i ditur. Te Taberani thuhet: “...doli që Muadhi është më i mirë se Ebu Musa.”

ADABI I GJUMIT

Adabe të gjumit janë dhjetë:

1. pastërtia; Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

“Kur robi i Allahut shkon në gjumë i pastër, shpirti i ngritet deri te Arshi, e ëndrrat e tij janë të vërteta. E nëse nuk shkon në gjumë i pastër, shpirti nuk ngritet e ëndrrat i janë të turbullta e të pavërteta.”⁵²

Këtu nënkuptohet pastëria e brendshme dhe e jashtme, e pastërtia e brendshme është shumë efektive në ngritjen e perdes së gajbit;

2. të përgatisë misvakun dhe ujë të pastër për abdes dhe të flej duke bërë nijet se do të ngritet të bëj ibadet, prandaj kur i del gjumi, i pastron dhëmbët me misvak. Kështu vepronin disa nga gjeneratat e para. Transmetohet se Resulallahu, s.a.v.s., disa herë gjatë natës, pra sa herë që zgjohej, i pastronte dhëmbët me misvak. Nëse nuk arrin të pastrohet plotësisht, është e dëshirueshme që me ujë të bëj mes’h në gjymtyrë, e nëse nuk gjen ujë, të ulet kthyer kah kibla e të bëj dhikr, të bëj dua dhe të mendojë për bereqetet dhe fuqinë e Allahut. Kjo do t’i vlejë sa namazi i natës. Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

“Atij që shkon në shtrat duke bërë nijet të ngritet dhe një pjesë të natës ta kalojë në namaz, e më pas e zë gjumi e nuk zgjohet deri në mëngjes, do t’i shkruhet ajo që e ka bërë nijet, e gjumin që nuk i ka dalë, e ka sadaka nga Allahu Teala”⁵³,

⁵² Tashmë është përmendur.

⁵³ Nesai dhe Ibn Maxhe nga Ebu Derda, me zinxhir të besueshëm.

3. Ai që ka ndonjë amanet, të mos flejë pa e shkruar testamentin dhe ta lë pranë vetes, sepse askush nuk është i sigurt që nuk do të vdes në gjumë. Ai që vdes e nuk ka lënë testament, nuk i lejohet të flasë në (*berzah*), deri në ditën e Gjykimit. E vizitojnë të vdekurit tjerë dhe thonë:

- *Ky i gjori ka vdekur, e nuk ka lënë testament.*

Pra, kjo është e dëshirueshme për shkak të frikës nga vdekja e papritur, e vdekja e papritur për atë që është përgatitur është një mirësi, por për atë që nuk është përgatitur, është vuajtje;

4. Të flejë duke u penduar për secilin gjynah, me mendim të mirë për secilin mysliman, dhe duke vendos që nuk do t'i bëj keq askujt dhe nuk do t'a urrej askënd kur të zgjohet. Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Ai që shkon në shtrat pa menduar si t'i bëj keq dikujt dhe pa urreyer askë, i falen gjynahet e bëra.”⁵⁴

5. Të mos e teprojë në përgatitje të shtratit, por të jetë modest. Disa nga gjeneratat e para përgatitjen për gjumë e konsideronin ngarkesë të panevojshme. *Ehlu-suff*⁵⁵ nuk shtronin asgjë mes vetes e dheut, dhe thoshin:

- *Nga dheu jemi krijuar, në dhé do të kthehem.*

Ata, këtë e konsideronin më të rehatshme për zemrat e tyre dhe më të përshtatshme për modestinë e tyre. Të tjerët, së paku le të jenë të matur.

⁵⁴ Ibn Ebu Dunja në '*Kitabu'n-Nijjet*' nga Enesi.

⁵⁵ As'habë që rrinin në xhaminë e Resulallahut, a.s., duke bërë ibadete.

6. Të mos shtrihet nëse nuk ka gjumë dhe mos ta detyrojë veten, pos kur dëshiron që pjesën e fundit të natës ta kalojë në namaz. Njeriu duhet të flejë atëherë kur gjumi i vjen, duhet të hajë kur është i uritur, të flasë kur është e nevojshme, e sipas kësaj janë përshkruar si **ata që flejnë vetëm një pjesë të shkurtë të natës**. Nëse nuk mund të falet e të bëj dhikr sepse nuk di çfarë po flet, duhet të flejë aq sa të bëhet i vetëdijshëm për fjalët e veta. Ibn Abbasit nuk i pëlqente të flejë ulur, e në një transmetim tregohet se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Dhe mos luftoni kundër natës.”⁵⁶

Një herë i thanë Resulallahut, s.a.v.s.:

- *Filan gruaja falë namaz natën, e kur e zë gjumi, e lidh vetën për litari*. Resulallahu, s.a.v.s., tha:

- **Secili prej jush le të falë natën aq sa mundet, e kur ta zë gjumi, le të flejë.**⁵⁷;

e gjithashtu ka thënë:

“Merrni mbi vete aq punë sa mundeni, sepse Allahut nuk do t’i mërzitet angazhimi juaj deri sa nuk ju mërzitet juve.”⁵⁸

Resulallahu, s.a.v.s., gjithashtu ka thënë:

“Më e mira në këtë fe është ajo që është më e lehta në të.”⁵⁹

⁵⁶ Ebu Mensur Dejlemi në ‘*Musned el-firdevs*’, nga Enesi.

⁵⁷ Buhari dhe Muslim, nga Enesi, r.a..

⁵⁸ Muttefekun alejhi, nga Ajshe r.anha.

⁵⁹ Ahmedi, nga Mihxhen b. Edre, përmendur në *Librin për diturinë*.

Një herë i thanë se filani falë namaz e nuk fle, agjëron e nuk ha, e ai, a.s., tha:

“Por unë edhe fali namaz edhe flej, edhe agjëroj edhe jam pa agjërim. Ky është sunneti im, dhe kush nuk i përshtatet kësaj, nuk është i imi.”⁶⁰

Dhe, gjithashtu ka thënë:

“Dhe mos e vështirësoni këtë fe, sepse ajo është e fortë dhe e qëndrueshme. Ajo do ta mund atë që vështirson. Prandaj mos ia bëni vetes të vështirë nënshtrimin tuaj Allahut Teala.”⁶¹

7. Të flejë kthyer kah kibla. Kjo bëhet në dy mënyra: e para është që të shtrihet në shpinë, dhe këmbët dhe i tërë trupi të jenë të kthyer kah kibla, sikur pozita e të vdekurit. Mënyra e dytë është të kthehet me anën e djathtë kah kibla, sikur në varr.

8. Të lexojë duanë para gjumit, e cila është:

Bismike rabbi veda'tu xhenbi ve bismike erfe'uhu... (Me emrin Tënd, o Rabbi im, unë po shtrihem, dhe me emrin Tënd ngritem...)⁶²,

si edhe dua tjera, që i kemi përmendur në fund të Librit për duatë.

⁶⁰ Nesai nga Abdullah b. Amr, pa pjesën *është sunneti im*. Kjo pjesë ndërlidhet me Ibn Huzejm. Muttefekun alejhi, Buhari e Muslim, nga Enesi.

⁶¹ Buhari, nga Ebu Hurejre, si edhe Bejheki, nga Xhabiri. Zinxhiri nuk është i besueshëm.

⁶² Është përmendur në *Librin për duatë*.

Është e dëshirueshme të lexohen edhe disa ajete Kur'anore, siç janë *Ajetul-kursijj*, ajetet e fundit të sures Bekare, si edhe ajetet:

“Zoti juaj është Një, Allahu, nuk ka zot pos Atij që është mëshirëplotë, gjithnjë mëshiron.

Është fakt se në krijimin e qiejve e të tokës, në ndërrimin e natës e të ditës, të anijes që lundron në det që u sjell dobi njerëzve, në atë shi që e lëshon Allahu prej së larti e me të ngjall tokën pas vdekjes së saj dhe përhapë në te nga çdo lloj gjallese, në qarkullimin e erërave dhe reve të nënshtruara mes qiellit e tokës, (në të gjitha këto), për një popull që ka mend ka argumente.”2-Bekare: 163, 164,

Transmetohet se atij që i lexon këto ajete para gjumit, ai e mëson Kur'anin përmendësh, dhe kurrë nuk e harron. Më pas duhet të lexojë këto ajete:

“Vërtet, Rabbi i juaj, Allahu, është Ai që krijoi qiejt dhe tokën brenda gjashtë ditësh, pastaj qëndroi mbi Arshin. Ai me errësirën e natës e mbulon ditën, e cila e ndjek atë; e Dielli, Hëna dhe yjet i përulën urdhërit të Tij. Ja, vetëm Atij i takon krijimi dhe sundimi. I madhëruar është Allahu, Rabi i botëve.

Luteni Rabbin tuaj të përulur e në heshtje, se Ai nuk i do ata që e teprojnë.

Dhe mos bëni çrregullime në tokë, kur në të është vënë rregulli, e Atij lutjuni duke pasur frikë (dënimin) dhe duke shpresuar (mëshirën). S'ka dyshim se mëshira e Allahut është pranë atyre që bëjnë vepra të mira.”

7-Araf: 54, 55, 56,

si edhe:

“Thuaj: *Thirre: Mëshiruesin* (Ja Rrahman!). *Me cilindo emër që ta thirrni ju Atë, Ai ka emrat më të bukur.*

Dhe thuaj: *Falënderuar qoftë Allahu, i cili nuk pati fëmijë dhe nuk ka për Të shok në sundim, dhe i cili nuk ka nevojë për ndihmës, dhe madhëroje Atë me madhërinë që i takon.*¹⁷-Isra: 110, 111.

Ai që i lexon këto, në rrobat e tij futet një melek që është përgjegjës ta mbrojë dhe të bëjë istigfar për të. Më pas duhet të lexojë suret Felek dhe Nas, e pas kësaj të fryjë në shuplaka dhe të fërkojë me to fytyrën dhe pjesën tjetër të trupit. Transmetohet se Resulallahu, s.a.v.s., kështu vepronte.⁶³Do të ishte mirë të lexojë dhjetë ajetet e para dhe dhjetë të fundit të sures Kehf. Këto ajete janë për zgjim për namazin e natës. Alia, r.a., ka thënë: *“Mendoj se njeriu me mendje të shëndoshë nuk do të flejë para se të lexojë ajetet e fundit të sures Bekare.”*

Dhe në fund, duhet që njëzet e pesë herë të thotë:

Subhanal-lahi vel-hamdu lil-lahi ve la ilahe il-lal-lahu val-lahu ekber. (Lavdëruar qoftë Allahu, hamdi i takon Allahut, nuk ka zot tjetër pos Allahut, Allahu është madhështori), pra 25, herë ***subhanal-lahi***, 25, herë ***elhamdulillah*** dhe 25 herë ***Allahu ekber*** ashtu që totali bëhet 100;

⁶³ Buhari dhe Muslim, nga Ajshe r.anha.

9. Para gjumit të kujtohet se fjetja është një lloj i vdekjes e zgjimi një lloj i ringjalljes. Allahu Teala thotë:

“Allahu i merr shpirtrat kur është momenti i vdekjes së tyre (i vdekjes së trupave të tyre), e edhe atë që është në gjumë e nuk ka vdekur.” 39-Zumer: 42

Më pas thotë:

“Ai jua merr shpirtrat (ju vë në gjumë) natën.”

6-Enam: 60.

Në këto ajete, Allahu Teala gjumin e quan *vdekje*. Ashtu si i paraqiten atij që është zgjuar pamje që nuk përshtaten me gjendjet e tij në gjumë, njëjtë edhe i ringjalluri do të shohë atë që kurrë as nuk ka mundur ta paramendojë, as ta shohë. Gjumi është gjendje mes jetës dhe vdekjes siç është *berzah* gjendje në mes të dynjallëkut dhe ahiretit. Me një rast, Llokmani i tha të birit: *“O biri im, nëse dyshon në vdekjen, as mos shko në gjumë, sepse sikur që shkon në gjumë, ashtu do të vdesësh. Nëse dyshon në ringjallje, mos u zgjo nga gjumi, sepse sikur që zgjohesh nga gjumi, ashtu do të ringjallesh.”*

Ka’b Ahbar ka thënë: *“Kur të flesh, shtriju në krahun e djathtë me fytyrën kah kibla, sepse fjetja është lloj vdekje.”*

Ajshe, r.anha tregon se e fundit që lexonte Resulallahu, s.a.v.s., para gjumit, duke mbështetur faqen në shuplakën e dorës së djathtë dhe duke menduar se do të vdes atë natë, ishte:

Allahumme rabbes-semavatis-seb'i ve rabbel-arshil-adhim. Rabbena ve rabbe kuli shej'in ve melikehu (*Rabbi im, rabb i shtatë qiejve dhe Arshit madhështor, Rabbi jonë, Rabb e Pronar i të gjithës, në qiejt dhe në Tokë*).⁶⁴

Është obligim i secilit rob të Allahut që para gjumit të mendojë për gjendjen me të cilën po fle, çfarë dominon te ai, dashuria për Allahun dhe për takim me Të, apo dashuria për dynjanë, e të jetë i bindur se do të vdesë e do të ringjallet me atë që e dominon, sepse njeriu është me atë që e do dhe me atë çfarë do;

10. Me secilin zgjim apo lëvizje, sado që të jenë, të lexojë atë që në aso raste e lexonte Resulallahu, s.a.v.s.:

La ilahe ilallahul-vahidul-kahkaru, rabbus-semavati vel-erdi ve ma bejnehumel-azizul-gaffar (*Nuk ka zot pos Allahut, të Vetmit, të Fuqishmit, Rabbit të qiejve, Tokës dhe asaj mes tyre, të Plotfuqishmit, Atij që falë shumë*).⁶⁵

Më pas synon që e fundit para gjumit dhe e para kur të zgjohet të jetë dhikri në zemër dhe në gjuhë, sepse dhikri është shenjë e dashurisë. Kështu duhet të veprojë për ta lidhur zemrën me afërsinë e Allahut. Prandaj duhet ta mësojë zemrën me dhikr. E kur të ngritet në mëngjes, duhet lexuar:

⁶⁴ Është përmendur në *Librin për duatë*, nga Hafsa, pa pjesën se e ka mbështetur faqen në dorë.

⁶⁵ Ibn Sunni and Ebu Nuajm në *Amelul-jevme vel-lejle* nga Ajshe r.anha.

El-hamdu lil-lahul-ledhi ahjana ba'de ma ematena ve ilejhin-nushur (Hamd Allahut, i Cili na ringjalli pasi që na ka vdekur. Para Tij të gjithë do të ringjallemi).

Pra, këto janë dhjetë adabet e gjumit.

Viridi i katërt i natës zgjatë nga gjysma e natës e deri mbetet vetëm edhe një e gjashta e saj. Kjo është koha kur personi zgjohet për namazin *tehxhut*, e *tehxhut* do të thotë zgjimi natën për namaz. Koha e këtij viridi fillon nga gjysma e natës, që i përngjanë virdit që fillon me mesditë. Kjo është koha me të cilën betohet Allahu Teala:

“Pasha natën kur shtrinë errësirën!” 93-Duha: 2

Ky është momenti kur mbizotëron qetësia dhe askush nuk është zgjuar përpos të Gjallit, të Përhershmit, Atij që nuk e zë gjumi, as dremitja. Me një rast, Resulallahu, s.a.v.s., u pyet se cila është pjesa e natës kur Allahu Teala më së shumti i pranon duatë, e u përgjigj:

- ***Mesi i natës.***⁶⁶

Davudi, a.s., pyeti:

- *Rabbi im, unë dua të të bëj ibadet Ty, prandaj, cila është koha më e mirë për këtë?;* e Allahu Teala i shpalli:

- **O Davud, mos u ngrit në fillim të natës e as në fund të natës, sepse ai që zgjohet në fillim të natës fle në fund të natës, e ai që zgjohet në fund të natës, nuk zgjohet në fillim të saj. Ngritu në mes të natës që të jemi bashkë dhe T'i pranoj të gjitha duatë.**

⁶⁶ Ebu Davud dhe Tirmidhi nga Amr b. Anbes.

E pyetën Resulallahun s.a.v.s., cila pjesë e natës është më e mira, e tha:

- ***Koha pas mesit të natës.***⁶⁷

Bile, transmetimet për këtë kohë flasin për dridhjen e Arshit, shpërndarjen e aromës nga bahçet e xhennetit, lëshimin e të Plotfuqishmit në qiellin e parë të Tokës.⁶⁸

Sa për renditjen e këtij viridi, pas duasë me rastin e zgjimit, merr abdes sipas rregullave dhe duave të përcaktuara, e më pas shkon në vendin për falje dhe hyn në namaz, duke u kthyer nga kibla, e duke thënë:

Allahu ekberu kebira. Vel-hamdu lil-lahi kesira. Ve subhanal-lahi bukreten ve esila (Allahu është Madhështori, Atij i qoftë hamd dhe i lavdëruar qoftë Ai, mëngjes e mbrëmje).

Pastaj thotë nga 10 herë *subhanallah, elhamdulillah* dhe *la ilahe illallah*, e më pas:

Allahu ekberu dhul-melekuti vel-xheberuti vel-kibrija'i vel-azameti vel-xhelali vel-kudre. (Allahu është më i madhi. Ai është Rabb i mbretërisë qiellore. Ai është i Gjithfuqishmi, i Forti, Fuqiploti dhe i Lartësuar).

⁶⁷ Ahmed b. Hanbel dhe Ibn Hibban nga Ebu Dherr.

⁶⁸ Hadithi për lëshimin e të Plotfuqishmit tashmë është përmendur. Për të tjerat, Muhammed b. Nasr nga Seid el-Xheriri, e në një rën nga to thuhet se Davudi, a.s., e pyeti Xhebrailin, e ai u përgjigj: “Nuk e di. E di vetëm se Arshi dridhet në agim.” Në transmetim nga Xheriri, ky nga Seid b. Ebu Hasan thuhet: “A nuk e ndjen se kur vjen agimi, shpërndahet aroma e secilit dru?” Nga Ebu Derda, që Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë: “Vërtetë Allahu Teala lëshohet në tri orët e fundit të natës...”, e dhikri fillon në orën e parë. Në hadith thuhet edhe: “Në orën e dytë, lëshohet në bahçe të xhennetit.”

E lexon edhe duanë për të cilën transmetohet se Resulallahu, s.a.v.s., e thoshte para namazit *tehaxhut*:⁶⁹

Allahumme lekel-hamdu, ente nurus-semavati vel-erd. Ve lekel-hamdu, ente beha'us-semavati vel-erd. Ve lekel-hamdu, ente rabbus-semavati vel-erd. Ve lekel-hamdu, ente kajjumus-semavati vel-erdi ve men fihinne, ve men alejhinne. Entel-hakku ve minkel-hakku, ve lika+uke hakkun, vel-xhennetu hakkun, ven-naru hakkun, ven-nushuru hakkun, ven-nebijjune hakkun, ve Muhammedun, s.a.v.s., hakk. Allahumme leke eslemtu, ve bike amentu, ve alejke tevekkeltu, ve ilejke enebtu, ve bike hasamtu, ve ilejke hakemtu, fagfir li ma kaddemtu, ve ma ehartu, ve ma esrertu, ve ma e'lentu ve ma esreftu, entel-mukaddimu ve entel-muehhiru, la ilahe ila ente. Allahumme ati nefsi takvaha ve zekkiha, ente hajru men zekkaha, ente velijjuha ve mevlaha. Allahummehdini li ahsenil-e'mal, la jehdi li ahseniha ila ente, vasrif anni sejj'eha, la jasrifu anni sejj'eha ila ente. Es'eluke mes'eletel-ba'isil-miskini ve ed'uke du'ael-muftekiriz-zelili, fe la texh'alni bi du'aike rabbi shekijja! Ve kun bi re'ufen rahimen ja hajrel-mes'uline ve ekremel-mu'tin

(O Allahu im, hamdi të takon vetëm Ty, ti je drita (nuri) e qiejve dhe Tokës. Hamd të takon vetëm Ty, ti je shkëlqimi i qiejve dhe Tokës. Hamd të takon vetëm Ty, Ti je i Përherhshmi në qiej e në Tokë dhe në mesin e atyre që

⁶⁹ Muttefekun alejhi, Buhari dhe Muslim, nga Ibn Abbas, pa fjalët: "Ti je shkëlqimi i qiejve dhe Tokës, hamdi të takon Ty, Ti je zbukurimi i qiejve dhe Tokës" dhe pa fjalët: "dhe atyre që janë në të. Ti je e vërteta"

janë me këto. Ti je e vërteta (hak) dhe nga Ti vjen e vërteta. Takimi me Ty është e vërteta, edhe xhenneti është e vërteta, edhe xhehenemi është e vërteta, edhe ringjallja është e vërteta, edhe pejgamberët janë e vërteta, edhe Muhammedi, s.a.v.s., është e vërteta. Rabbi im, Ty të nënshtrohem, në Ty besoj, në Ty mbështetem, tek Ti pendohem. Më fal për ato që i kam bërë, e nuk kam guxuar t'i bëj, dhe atë që nuk e kam bërë, e është dashur ta bëj. Më fal për atë që e kam bërë fshehtas dhe për atë që e kam bërë haptas, dhe për atë që e kam tepruar. Ti je Ai që dhuron dhe Ai që merr. Nuk ka zot tjetër pos Teje. Rabbi im, bëje shpirtin tim të ketë frikë nga Ti, dhe bëje të pastër, sepse Ti je Ai që këtë më së miri e bën. Ti je mbrojtës dhe pronari i saj.⁷⁰ Rabbi im, më udhëzo të bëj vepra të mira, sepse vetëm Ti mund të më udhëzosh në to, dhe më largo nga veprat e këqija, sepse vetëm Ti mund të më largosh nga to⁷¹. Duanë po ta drejtoj unë, i pafuqishmi, një fukara modest e i përulur⁷², prandaj mos më konsidero të pasjellshëm e të paturpshëm. Bëhu ndaj meje i mëshirshëm dhe mëshirplotë, o Ti i Cili je dhuruesi më i madh dhe më fisniku.)

⁷⁰ Ahmedi, ne zinxhir të mirë, nga Ajshe, r.anha, që tregon se një natë e pa që Resulallahu, s.a.v.s., nuk është në shtrat, e duke e kërkuar me duar ra mbi të, derisa ai ishte në sexhde, e atëherë ka thënë: “Rabbi im, bëje shpirtin tim të ketë frikë nga Ti..”

⁷¹ Muslimi, nga Alia, r.a..

⁷² Taberani në *Sagir* nga Ibn Abbas, si dua që Resulallahu, s.a.v.s., e lexoi në natën e Arafatit. Është përmendur në *Librin për haxhin*.

Ajshe r.anha thotë se Resulallahu, s.a.v.s., e fillonte namazin e natës me fjalët:

Allahumme rabbe Xhibrile, ve Mika'ile, ve Israfile, fatires-semavati vel-erdi, alimel-gajbi vesh-shehadeti, ente tahkumu bejne ibadike fima kanu fih i jahtelifun. Ihdini lima-htulife fih i minel-hakki bi iznike, inneke tehdi men teshu' u ila siratin mustekim (Rabbi im, Rabb i Xhebrailit, Mikailit dhe Israfililit, Krijuesi i qiejve dhe Tokës, Njohës i botës së dukshme dhe asaj të padukshme. Ti je Ai që gjykon mes njerëzve në atë ku ata ndahen, më udhëzo në të vërtetën për të cilën mendimet ndahen, Ti udhëzon në rrugë të drejtë [sirati mustakim] atë që Ti dëshiron.)⁷³

Pas kësaj fillon me namaz dhe falë fillimisht dy reqate të shkurtë, e më pas nga dy, aq sa mundet, e përfundon (me një reqat) namazin vitri, nëse nuk e ka falë më herët.

Është e dëshirueshme që të bëj pauzë në mes të dy namazeve, pas selamit me njëqind tesbihë, që të pushojë e të mbledhë energji për namaze tjera. Për namazin e natës, në transmetim të besueshëm tregohet se Resulallahu, s.a.v.s., i falte një herë dy reqate të shkurtë, më pas dy të gjatë, më pas edhe dy pak më të shkurtë, dhe kështu gradualisht i shkurtonte, deri sa të arrinte në 13 reqate.⁷⁴ E pyetën një herë Ajshen r.anha, se a lexonte Resulallahu, s.a.v.s., në namaz të natës me

⁷³ Muslimi, nga Ajshe, r.anha.

⁷⁴ Muslimi, nga Zejd b. Halid Xhuheni.

zë apo në vete, e Ajshe r.anha, tregoi se nganjëherë i lexonte me zë, e nganjëherë në vete.⁷⁵

Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Falni namazin e natës me dy nga dy reqate, e kur të afrojnë agimi, falni një reqat vitr namaz”⁷⁶, si edhe:

“Namazi i akshamit bën që reqatet e namazeve ditore të jenë numër tek, e ju falni vitr namaz, që edhe namazet e natës të jenë tek.”⁷⁷

Në shumicën e transmetimeve të besueshme në lidhje me namazin e natës thuhet se Resulallahu, s.a.v.s., i falte 13 reqate⁷⁸ dhe në këto reqate lexonte ndonjë ajet të njohur ose ndonjë sure që i ishte më e lehtë. Ky vird përfundon para pjesës së fundit nga një e gjashta e natës.

Virdi i pestë përfshinë një të gjashtë pjesë të fundit të natës, që është koha para agimit, të cilën Allahu Teala e përmend në ajet:

“Dhe në agim (kah mbarimi i natës) ata kërkonin falje për mëkatet.” 51-Dharijat: 18.

Njerëzit pra, falin namaz në këtë kohë për të kërkuar falje. Kjo është koha e natës afër agimit, ku ndërrohen melekët e natës me ata të ditës. Selmani i urdhëroi të vëllazëruarit të vet, Ebu Derdas këtë vird, kur një natë i shkoi në vizitë; në fund të një hadithi të

⁷⁵ Ebu Davud, Nesai dhe Ibn Maxhe, me zinxhir të besueshëm.

⁷⁶ Muttefekun alejhi tashmë është përmendur.

⁷⁷ Ahmedi, nga Ibn Omeri.

⁷⁸ Tashmë është përmendur.

gjatë thuhet se Ebu Derda, kur ra nata, deshi të falë namazin e natës, e Selmani i tha të flejë, dhe ai e dëgjoi. Pas një kohe Ebu Derda përsëri deshi të falë namaz, e Selmani përsëri e ktheu në shtrat. Para agimit, Selmani i tha të ngritet, u falën bashkë, e Selmani i tha:

- *Trupi yt i ka të drejtat e veta te ti, mysafiri yt, gjithashtu, e edhe familja jote. Je i obliguar që secilit t'ia japësh të drejtën e vet.* Selmani veproi kështu sepse gruaja e Ebu Derdas e njoftoi që ai natën nuk flinte. Më pas shkuan te Resulallahu, s.a.v.s., dhe e njoftuan për këtë, e ai ju tha:

- ***Selmani e ka thënë të vërtetën.***⁷⁹

Ky është viridi i pestë, kur është mirë të jetë zgjuar, që të mos flejë kur vjen agimi. Obligimi kryesor në këto kohë është namazi. Kur fillon agimi, ndalen virdet e natës e fillojnë ata të ditës, dhe atëherë ngritet dhe i falë dy reqate të namazit të sabahut, që Allahu Teala i përmend në ajetin Kur'anor:

“Edhe gjatë natës adhuroje Atë, si dhe kur yjet nuk duken më.” 52-Tur: 49, e pas kësaj, lexon ajetin:

“Allahu dëshmon se Ai është vetëm një, por edhe engjëjt e të diturit, duke qenë të qëndrueshëm në të vërtetën. S'ka zot tjetër përveç Tij. Ai është i Plotëfuqishëm dhe i Gjithëdijshëm.” 3-Ali Imran: 18, e pastaj thotë:

Ve ene eshhedu bima shehidal-lahu bihi li nefsihi ve shehidet bihi mela'iketuhu ve ulul-ilmi min halkihi vestevdi'ul-lahe hazihish-shehadete ve hije li indel-lahi te'ala vedi'atun ves'eluhu hifzaha hatta jeteveffani

⁷⁹ Buhari, nga Ebu Xhuhajfe.

alejha. Allahummahtut anni biha vizren vexh'alha li indeke zahren vehfazha alejje ve teveffeni alejha hatta elkake gajre mubeddilin tebdila (Edhe unë e dëshmoj atë që Allahu Teala dëshmon për Vetën, dhe që e dëshmojnë melekët dhe dijetarët. Allahut Teala ia besoj këtë dëshmi, dhe dëshiroj nga Allahu të vdes me këtë dëshmi. Allahu im në saje të kësaj dëshmie m'i fal gjynahet dhe ma merr shpirtin tim me këtë dëshmi, pa u ndryshar aspak).

Kjo pra është renditja e vidreve, e është mirë që çdo ditë ta shtojë edhe agjërimin, sadakanë, qoftë edhe e vogël, vizitën të sëmurit dhe përcjelljen e xhenazes, sepse me një hadith, Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Do të falet ai që i bashkon këto katër (agjërim, sadaka, vizitë të sëmurit dhe përcjellje të xhenazes) **në një ditë”,** e në transmetim tjetër:

“...do të hyjë në xhennet.”⁸⁰

Nëse e bën ndonjërin, e tjerat jo, do të shpërblehet sipas nijetit. As'habëve nuk ju pëlqente kur ju kalonte dita e të mos japin sadaka, qoftë edhe një hurme ose copë buke, sepse Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Personi do të jetë nën hijen e sadakasë së vet, deri sa t'ju gjykohet njerëzve”⁸¹, dhe:

“Ruajni nga zjarri, qoftë edhe me gjysëm hurme.”⁸²

⁸⁰ Muslimi, nga Ebu Hurejre.

⁸¹ Ibn Hibban

⁸² Buhariu dhe Muslim nga Adijj b. Hatemi.

Një ditë, Ajsha, r.anha i dha një lypsari një kokërr rrushi, ai e mori, e njerëzit afër filluan ta shikojnë njëri-tjetrin, e Ajsha r.anha, tha:

- *Çfarë keni?! Në të (në një kokërr rrushi) ka vlerë të madhe!”*

As’habëve nuk ju pëlqente të refuzojnë lypsin, sepse kjo nuk i pëlqente as Resulallahut, s.a.v.s.. Ai nuk e refuzonte askë, e nëse nuk mund të jepte atë që i kërkohej, atëherë vetëm heshte.⁸³ Sipas një transmetimi, Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Personi zgjohet nga gjumi, e në secilën nyje të tij jepet sadaka (në trupin e njeriut ka 360 nyje). Urdhërimi për vepra të mira (emri maruf) është sadaka, ndalimi nga e keqja (nehji munker) është sadaka, ta ndihmohet të dobëtin është sadaka, udhëzimi në rrugë të drejtë është sadaka, largimi i pengesës (nga rruga) është sadaka; bile e ka përmendur edhe tesbihun dhe tehlilin si sadaka, e më pas ka shtuar: *...dy reqate të duha-namazit i zëvendësojnë këto.*”⁸⁴

⁸³ Muslimi, nga Xhabiri, e Bezari nga Enesi, ku thuhet: *“ose heshte.”*

⁸⁴ Muslimi, nga Ebu Dherr.

NDËRRIMI I VIRDEVE SIPAS GENDJEVE

Dije, ai që dëshiron të fitojë shpërblimin e ahiretit, që vepron në këtë rrugë dhe që shkon kësaj rruge, është në njërën prej këtyre gjashtë gjendjeve: është abid⁸⁵, dijetar, nxënës, punëtor, udhëheqës ose *muvahhid* - besimtar; i tilli i është kushtuar vetëm Allahut Teala;

1. Abidi. Ky është ai që i është kushtuar vetëm ibadetit, e nuk bën asgjë tjetër. Nëse e braktisë ibadetin, rri kot dhe është dembel. Renditja e virdeve të tij është pikërisht e tillë që e paraqitëm këtu.

Natyrisht, nuk përjashtohet që virdet të jenë të ndryshëm, ashtu që shumica e kohës mund t'i kalojë ose në namaz, ose duke lexuar Kur'an, ose në tesbih. Ka pasë as'habë, virdi i të cilëve për një ditë përbënte 20,000 tesbihë. Kishte edhe të atillë që virdi i tyre ishte prej 300 deri 600 reqate, bile edhe deri në 1000. Virdi më i vogël gjatë një dite e nate, siç transmetohet, kishte 100 reqate. Te disa, virdi më i përhapur ishte leximi i Kur'anit. Disa lexonin gjithë Kur'anin një herë gjatë një dite e nate, e disa edhe nga dy herë. Disa, nga ana tjetër, e kalonin kohën duke menduar vetëm për një ajet, duke e përsëritur pandërprerë. Kurrez b. Veбра jetonte në Meke, dhe çdo ditë bënte tavaf rreth Qabes 70 herë (një tavaf i ka 7 rrotullime rreth Qabes dhe 10 fersahë). Po aq herë bënte tavaf edhe në mbrëmje. Krahas kësaj, nga dy herë në ditë e lexonte Kur'anin, me nga dhjetë pauza. Në kuadër të secilit tavaf i falte nga dy

⁸⁵ **Abid:** ai që bën shumë ibadet; zahid.

reqate, që në total është 280 reqate, dy hatme dhe dhjetë pauza. Domethënë, ky person çdo 24 orë vrapon 10 fersahë, falë 280 reqate dhe dy herë bën hatme.

Nëse ti pyet se, përpos kësaj, në çka është më së miri të kalohet koha, dije se leximi i Kur'anit në namaz, duke e kuptuar, i përfshinë të gjitha ibadetet. Por, nganjëherë njeriu lodhet dhe nuk vazhdon. Prandaj më së miri është që ibadetet të ndërrohen, sipas rrethanave dhe gjendjes së personit. Qëllimi i virdeve është pastrimi i zemrës, zbukurimi dhe lumturimi i saj me dhikr. Prandaj personi duhet ta përcjellë se çka më së shumti ndikon në zemrën e tij, dhe të qëndrojë në atë ibadet, e kur ta vërejnë se ai po ju mërzitet, le të kalojnë në ibadet tjetër.

Ne mendojmë se më e përshtatshme për shumicën e njerëzve është t'i renditin këto ibadete siç e bëmë ne këtu, e pastaj të kalojnë nga njëri në tjetrin, sepse në natyrën e njeriut mërzitja dhe dembelia janë më të forta, e edhe disponimi në lidhje me to ndryshon. Por, nëse njeriu e kupton virdin dhe esencën e tij, le të udhëhiqet me këtë. Kur dëgjon ndonjë tesbih dhe ndjen ndikim në zemër, le ta përsërisë edhe vet, deri sa ta gjejë kënaqësinë në të. Transmetohet se Ibrahim b. Ed'hem një natë u ngrit të falet buzë detit, dhe e dëgjoi një zë të fortë si bën tesbih, por nuk e pa askë, e thirri:

- *Kush je ti, që zërin ta dëgjoj, e trupin nuk ta shoh?*; e mori përgjigje:

- *Unë jam meleku përgjegjës për këtë det, Allahun e madhëroj kështu prej se jam krijuar. Ibrahim i pyeti:*

- *Si quhesh?*; e meleku iu përgjigj:

- *Emri im është Mehjehail. Ibrahim i përsëri e pyeti:*

- Çka është shpërblimi për atë që kështu e madhëron Allahun Teala?; e meleku u përgjigj:

- Ai që e thotë këtë tesbih 100 herë, nuk do të vdesë pa e parë vendin e vet në xhennet; e ky tesbih është:

Subhanal-lahil-alijid-dejjan.Subhanal-lahish-shedidil-ekran. Subhane men jezhebu bil-lejli ve je'ti bin-nehar. Subhane men la jushgiluhu she'nun an she'nin. Subhanal-lahil-hannanil-mennan.Subhanal-lahil-musebbehi fi kulli mekan (I lavdëruar qoftë Allahu, Rabbi i lartësuar. I lavdëruar qoftë Allahu, i Forti dhe Fuqploti. I lavdëruar qoftë Ai të Cilin një gjë nuk e largon nga tjetra. I lavdëruar qoftë Allahu, Mirëbërësi Mëshirues. I lavdëruar qoftë Allahu, të Cilit gjithkrah i bëhet tesbih...)

Kur personi dëgjon këso dhe fjalë të ngjashme, dhe në to gjen kënaqësi, le të vazhdojë me to. Në çfarë do ibadeti që të gjejë ndonjë kënaqësi dhe zemra i hapet, aty e ka hajrin dhe me të personi duhet të vazhdojë.

2. **Dijetari**, që me diturinë e vet është i dobishëm për njerëzit, duke marrë vendime të fikhut, duke i mësuar, duke shkruar libra etj. Për këtë, virdi i tij dallon nga virdi i abidit. Ky duhet të lexojë libra, të shkruajë dhe t'i mësojë të tjerët, e të gjitha këto marrin kohë. Nëse ia arrin që kohën ta kalojë me këto, kjo është më e mira për të, pas pesë namazeve ditore dhe atyre të kohëpaskohshme. Këtë e dëshmon krejt ajo që e kemi përmendur në lidhje me mësimin në *Librin për diturinë*. E si të mos jetë kështu, kur dituria nënkupton edhe vazhdueshmëri në dhikër, edhe mendim për atë që e thotë Allahu Teala dhe Resulallahu, s.a.v.s.. Në dituri

është edhe dobia edhe udhëzimi për njerëzit, që i dërgon drejt shpërblimit në ahiret. Mund të ndodhë që personi mëson diçka me të cilën e përmirëson ibadetin dhe, sikur të mos e përvetësonte atë, mundimi i tij do të ishte i kotë. Me dituri që i paraprinë ibadetit po mendojmë në atë dituri e cila te njerëzit ngjallë dëshirën për ahiret dhe njëherësh i bën të paimterësuar ndaj dynjasë, pra dituria që i udhëzon në rrugën drejt shpërblimit të ahiretit. Këtu nuk bën pjesë dituria që e shton dëshirën për pasuri, reputacion dhe simpati te njerëzit. E edhe koha e kushtuar diturisë, gjithashtu duhet ndarë. Natyra njerëzore nuk mund ta përballojë teprimin me mësim.

Prandaj kohën në mes të agimit dhe lindjes së Diellit duhet kushtuar ibadeteve që i përmendëm kur folëm për virdin e parë.

Nga lindja e Diellit deri në namazin e duhas (paraditës) kohën duhet kushtuar mësimin të të tjerëve, nëse ka aso që dëshirojnë ta përdorin diturinë për të fituar shpërblim në ahiret. Nëse nuk ka, atë kohë ia kushton mendimit për dituritë e fesë që njerëzit nuk i kanë të qarta, sepse zemra, pas dhikrit e para angazhimit me dynjallëk, është e hapur për të menduar për problemet. Nga paradita e deri në ikindi duhet t'i kushtohet leximit dhe shkrimit, duke bërë pauza vetëm në kohën e ushqimit, kryerjes së nevojave trupore, marrjes së abdesit, namazeve të caktuara dhe një pushimi të vogël, nëse është dita e gjatë. Nga namazi i ikindisë e deri te lajmërimi i të verdhës së akshamit, koha i kushtohet dëgjimit të tefsirit, hadithit ose ndonjë

tjetër dituri e dobishme që lexohet para nesh. Nga lajmërimi i verdhësisë së akshamit, deri në perëndim të Diellit, duhet t'i kushtohet dhikrit, istigfarit dhe tesbihut. Pra, viridi i parë i dijetarit bëhet deri në lindjen e Diellit dhe nënkupton ibadet të gjuhës. Viridi i dytë i tij nënkupton punë intelektuale (mendim) dhe vazhdon deri paradite. Viridi i tretë i zgjatë deri në ikindi dhe përfshinë punë të syve dhe duarve, respektivisht lexim dhe shkrim. Viridi i katërt i fillon nga ikindia dhe nënkupton angazhim të veshëve, pra dëgjim, që sytë dhe duart të pushojnë nga leximi dhe shkrimi.

Kur perëndon Dielli, i kthehemi dhikrit dhe ibadetit, ashtu që asnjë pjesë e ditës nuk mbetet pa aktivizuar ndonjë pjesë të trupit në ibadet, e zemra është prezente në secilin prej tyre. Ndarja më e mirë për natën është ajo e Imam Shafisë, që e ndanë në tri pjesë. Pjesa e parë parashihet për lexim dhe dituri, pjesa e dytë për namaz, dhe e treta për fjetje. Kjo ndarje është e përshtatshme edhe në verë edhe në dimër, e është e mundur vetëm nëse flihet ditën. Kjo është renditja e virdeve të dijetarit që ne e konsiderojmë të dëshirueshëm.

3. **Nxënësi.** Mësimi është më i mirë se dhikri e nafilet për nxënësin. Krejt çka vlen për dijetarin në lidhje me renditjen e virdeve vlen edhe për nxënësin. Nxënësi mëson atëherë kur me këtë renditje parashihet që dijetari t'i mësojë të tjerët, ndërsa mbanë shënime dhe shkruan atëherë kur është paraparë që edhe dijetari të shkruajë. Nxënësi e rendit kohën ashtu siç e shpjeguam, e të gjitha që i përmendëm në lidhje me vlerën e mësimin dhe diturisë në *Librin për diturinë* e tregon se

kjo është më e mira. Aq më shumë, nëse personi nuk është nxënës, në kuptim që shkruan e mëson që të bëhet dijetar, por është njeri i rëndomtë, më mirë e ka të marrë pjesë në tubimet e diturisë dhe në ato ku mbahen ligjëratat dhe bëhet dhikr, se sa t'i bëjë viridet që janë paraparë pas agimit, pas lindjes së Diellit etj. Në hadith nga Ebu Dherr, Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

“Të gjendesh në një mexhlis (tubim) të diturisë është më e vlefshme se falja e njëmijë reqateve namaz (nafile), vizita njëmijë të sëmurve dhe përcjellja e njëmijë kufomave”⁸⁶, e më pas ka thënë:

- Kur kaloni pranë bahçeve të xhenetit, shfrytëzoni nga aty sa më shumë: hyni brenda, hani, pini.

Kur as'habët pyetën:

- *Ku janë këto bahçe?*, Pejgamberi, s.a.v.s., tha:

- ***Janë tubimet e dhikrit.***⁸⁷

Ka'b Ahbar ka thënë: *“Sikur njerëzit të ishin të vetëdijshëm për sevapin e mexhlisit të diturisë, do të luftonin mes vete për të marrë pjesë në takimet e tyre, sa që edhe sundimtari do ta braktiste pushtetin, e tregtari pazarin.”*

Omer b. Hattab ka thënë: *“Njeriu do të dalë nga shtëpia një ditë, me gjynahe sa mali Tehame. Kur të dëgjojë këshillat dhe vazin e dujetarit do ta kaplojë frika, e do të pendohet për gjynahet e veta dhe do të kthehet në shtëpi i pastër prej tyre. Prandaj mos i braktisni tubimet e diturisë, sepse Allahu Teala nuk ka krijuar në Tokë asgjë më të ndershme se tubimet e dijetarëve.”*

⁸⁶ Është përmendur në *Librin për diturinë*.

⁸⁷ Është përmendur në *Librin për diturinë*.

Një person iu ankua Hasan Basriut për ashpërsinë dhe egërsinë e vet, e Hasani i tha të merr pjesë në tubimet të diturisë. Amar Zahidi pa në ëndërr një jetime, që ishte e rregullt në tubimet e diturisë, e i tha:

- *Mirë se erdhe, o meskine*; e ajo i tha:

- *Larg qoftë, ngushtimi u largua, e bereqeti erdhi.*

- *Çudi kjo*, tha ai, e ajo ia ktheu:

- *Nuk po pyet me çka e fiton personi xhennetin, dhe të hyj në të nga cila do anë!*

- *Me çka?!; pyeti ai, e ajo iu përgjigj:*

- *Me shoqërim me ata që bëjnë dhikr.*

Me një fjalë, ajo që në bazë të fjalëve të vaizit të matur e gjuhë-ëmbël largon nga zemra dashurinë ndaj dynjasë, ani pse zemra është e angazhuar me atë dashuri, është më e vlefshme dhe më e dobishme se numri i madh i rekateve të namazit nafile.

4. **Punëtori**, të cilit i duhet të fitojë për familjen e vet. Ai nuk guxon ta lë anash familjen e kohën t'ia kushtojë vetëm ibadetit. Në kohën e paraparë për punë, *virde* i këtyre është të shkojë në punë e të fitojë. Megjithatë, as në punën e vet njeriu nuk guxon ta harrojë Allahun Teala, por i duhet që pandërprerë të jetë në tesbih, dhikr dhe Kur'an, meqenëse këto mund të bëhen edhe gjatë punës. Namazi nuk është i lehtë të bëhet gjatë ditës, pos nëse personi është në pozitë udhëheqëse, pasi që në atë rast është në gjendje t'i bëjë *virde* e ndërlihdura me namaz. Më pas, kur ta përfundojë punën, i kushtohet *virde*it. Nëse punon më shumë, dhe e shpërndanë fitimin e tepërt, kjo i është më e mirë se sa *virde*it që i përmendëm, sepse ibadetet

nga të cilat përfitojnë edhe të tjerët janë më me vlerë se sa ibadetet që nuk ndërlidhen me të tjerë. Sadakaja dhe puna me këtë nijet është ibadet vullnetar, që e afron njeriun Allahut Teala. Në atë rast, me punën e vet, njeriu sjell dobi edhe për të tjerët, dhe me duatë që njerëzit ia drejtojnë Allahut Teala, sevapi dhe shpërblimi i shtohet shumë më tepër.

5. **Udhëheqësi.** Këtu nënkuptojmë ndonjë kryetar shteti, guvernator, imam, udhëheqës, gjykatës, që udhëheqë me punët e myslimanëve, etj.

Angazimi i sinqertë për nevojat e myslimanëve përshtatshëm shariatit është më me vlerë se virdet e përmendura. I tilli duhet ditën t'i kryejë farzet dhe t'i kushtohet të drejtave të njerëzve, si edhe obligimeve fetare, e natën virdeve të përmendura. Kështu vepronte Omeri, r.a., i cili ka thënë: *“Si të flejë?! Nëse fle ditën, i dëmtoj myslimanët, e nëse fle natën, e dëmtoj veten.”*

Nga kjo që e përmendëm mund të përfundohet se me ibadete fizike (trupore) nënkutohen dy gjëra: dituria dhe sjellja e mirë ndaj myslimanëve. Edhe njëra edhe tjetra janë vepra të vlefshme dhe ibadet më i mirë se ibadetet tjera, sepse prej tyre kanë dobi edhe të tjerët.

6. **Muvahhid;** Besimtari, i përkushtuar vetëm Allahut Teala. Ky person nuk mendon asgjë tjetër përpos Allahut. Ai nuk e do askë tjetër përpos Allahut Teala, e as nuk i frikësohet askujt pos Allahut. Ai furnizimin e di prej Allahut, dhe çfarëdo të shikojë, e sheh vetëm Allahun Teala. Ai që e arrinë këtë gradë, nuk duhet t'i ndryshojë virdet. Viridi i tij i vetëm, pas

obligimeve farz, është që në secilin çast në zemrën e tij të jetë prezent Allahu Teala, ashtu që asgjë tjetër më nuk i vjen në mendje, asgjë tjetër nuk arrinë veshët e tij, asgjë tjetër nuk ia tërheq shikimin, e që aty të mos gjej ndonjë porosi dhe kuptim. I Vetmi që mund t'i nisë e t'i ndalë këto është Allahu Teala. Të këtillët, në secilin rast e shtojnë ibadetin e vet, ashtu që te ata një ibadet nuk ndryshon nga tjetri. Këta janë njerëz që vrapojnë për tek Allahu Teala, e për ta, Allahu Teala thotë:

“...Ne krijuam prej çdo gjëje çifte, që të mediton!

Pra, vraponi tek Allahu...” 51-Dharijat: 49, 50

Edhe në vazhdim, Allahut Teala thotë:

“Kur t'i lëni ju ata dhe prej asaj që adhurojnë ata, pos Allahut, atëherë strehohuni në shpellë, e Rabbi juaj ju dhuron nga mëshira e tij.” 18-Kehf: 16

Këtë e tregon edhe ajeti:

“(Ibrahimi) tha: “Unë po shkoj te Rabbi im. Ai do të më udhëzojë.” 37-Safat: 99.

Kjo është grada më e lartë e atyre që janë të sinqertë e të drejtë (sëdëk), e aty arrihet vetëm me vazhdimësi në virde për një periudhë më të gjatë. Njeriu nuk duhet të mashtrohet me këtë që e thamë, e të pohojë që ka arrit në këtë gradë, e të dembeloset në ibadet, sepse kjo mund të jetë vetëm nxitje të mos bëj gjynahe dhe të këqija dhe të mos ngarkohet me frikë dhe me telashe të mëdha. Vështirë që secili mund ta posedojë këtë gradë, prandaj deryra e secilit është të vazhdojë virdin ashtu siç e përshkruam.

Gjithçka që përmendëm janë rrugë drejt Allahut Teala, e Allahu Teala thotë:

“Thuaj: Çdokush punon në mënyrë të vet, e Rabbi juaj di më së miri kush është në rrugën më të drejtë.”

17-Isra: 84

Dhe të gjithë që ne i përmendëm janë në rrugë të drejtë, disa më shumë se të tjerët. Sipas një transmetimi, Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Besimi shprehet në 333 mënyra. Kush e takon Allahun Teala me shehadet, duke e shprehur besimin në njërën nga këto 333 mënyra, do të hyjë në xhennet.”⁸⁸

Disa dijetarë thonë: *“Besimi shprehet në 313 mënyra, aq sa ka edhe pejgamberë. Secili besimtar që e shpreh besimin në njërën nga këto mënyra, është në rrugë që dërgon Allahut Teala.”*

Pra, edhe pse mënyrat e bërjes ibadet ju ndryshojnë, të gjithë njerëzit (që bëjnë ibadet në njërën nga mënyrat e përmendura), janë në rrugë të drejtë. Allahu Teala thotë:

“Ata që i luten atyre, vetë kërkojnë mënyrë ndërmjetësimi t’i afrohen Rabbit të tyre .” 17-Isra: 57

Por, ata dallojnë vetëm në gradën e afërsisë, e më së afërti Allahut Teala janë ata që më së miri e njohin Allahun, e ata që e njohin më së miri gjithsesi më shumë bëjnë ibadet dhe janë më të devotshmit, sepse ai që e njeh Allahun nuk do të adhurojë tjetër pos Tij.

⁸⁸ Ibn Shahin dhe Lalkai, në ‘Es-Sunna, Taberani dhe Bejheki në ‘Shuabu’l iman’, nga Mugir b. Abdurrahman b. Ubejd,

Te virdet, për cilën do kategori të njerëzve, vazhdimësia është më e rëndësishmja, sepse qëllim i tyre është të përmirësojnë vetet e të përfitojë virtyte. Disa vepra kanë pak, ose më mirë të themi shumë pak ndikim, bile ndikimi as nuk ndjehet. Ndikimi lajmërohet nga të gjitha veprimet bashkë. Kur një vepër ka pak ndikim, e veprat tjera nuk vijnë shpejt pas saj, zhuket edhe ndikimi i parë. Domethënë, duhet vazhdimësia. Kjo është si puna e personit që dëshiron të depërtojë në fshehtësitë e shpirtit, e nuk do t'ia arrijë pa vazhdimësi dhe përsëritje. Nëse e kalon një natë në përsëritje, e më pas bën ndërprerje prej një jave apo një muaji, dhe prapë i kthehet asaj për një natë, kjo nuk do të ketë kurrfarë ndikimi. E sikur atë që ka synim ta bëj për një natë ose dy, ta kishte ndarë dhe praktikuar në disa netë në vazhdimësi, do të arrinte efektin.

Prandaj Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Veprat më të dashura për Allahun janë ato në vazhdimësi, që zgjasin më së shumti, edhe nëse janë të vogla.”⁸⁹

E pyetën një herë Ajshen r.anha për veprimet e Resulallahut, s.a.v.s., e ajo tha:

“Veprat e tij ishin afatgjate, dhe kur diçka bënte, vazhdonte me atë veprim.”⁹⁰

Në këtë kuptim, Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Atë që Allahu e mëson në një ibadet, dhe ky e braktisë nga mërzitja, Allahu e urren.”⁹¹

⁸⁹ Buhari dhe Muslim, nga Ajshe r.anha.

⁹⁰ Muslimi.

Për këtë arsye, Resulallahu, s.a.v.s., një ditë po falej pas namazit të ikindisë, duke kompenzuar dy reqate të drekës që i lëshoi për shkak të një misioni, e më pas vazhdoi të veprojë ashtu për çdo ditë, por në shtëpi, e jo në xhami, që të tjerët të mos fillojnë ta imitojnë.⁹² Kjo transmetohet nga Ajshe r.anha dhe Ummu Seleme.

Nëse ti pyet se a kanë të tjerët të drejtë ta imitojnë në këtë, ani pse kjo është kohë kur është *mekruh* të falet namaz, dije se ato tri gjëra që i kemi përmendur kur folëm për kohën kur është mekruh të falet namaz, si mbrojtje nga përngjasimi me ata që adhurojnë Diellin, ose me ata që bijnë në sexhde kur të lajmërohet briri i shejtanit, ose për të pushuar nga ibadetet që të evitohet mërzitja me to, kjo nuk ka të bëj me Resulallahun, s.a.v.s.. Në këtë, të tjerët nuk mund të krahasohen me Resulallahun, a.s., që e vërteton edhe fakti se këto dy reqate i ka falë në shtëpi, pikërisht që të tjerët të mos e imitojnë.

⁹¹ Është përmendur në *Librin për namazin*, e zinxhiri i transmetuesve ndërprehet te Ajshe r.anha.

⁹² Muttefekun alejhi, Buhari dhe Muslim nga Ummu Seleme, që Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë: “*Më penguan anëtarët e fisit Abdulkajs t’i falë dy reqate pas namazit të drekës*”; dhe nga Ajshe r.anha: “*Nuk i braktisi deri sa u takua me Allahun. I falte, por jo në xhami, me frikë se ju vështirëson ummetit të vet.*”

Kapitulli i dytë
**NETËT E LAVDËRUARA PËR RIGJALLËRIM ME IBADET,
FAZILETI I IBADETIT TË NATËS DHE PJESËT E NATËS PËR
IBADET**

FAZILETI I IBADETIT MES AKSHAMIT DHE JACISË

Me një transmetim nga Ajshe r. anha., Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Namazi më i vlefshëm tek Allahu është namazi i akshamit. Kjo vlen edhe për mysafirin edhe për mukimin (atë që rri në vend të vet). Me namazin e akshamit përfundon namazi i ditës dhe filon namazi i natës. Atij që pas farzit të akshamit i falë dy reqate sunnet, Allahu Teala ia ndërton dy pallate në xhennet. Atij qëi falë katër reqate, ia fal gjyahete njëzet viteve; ose ka thënë: katërdhjetë viteve.”⁹³

Ummu Seleme dhe Ebu Hurejre transmetojnë se Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Ai që i falë gjashtë reqate pas farzit ta akshamit, përfiton sevapin e (bërjes ibadet nafile përgjatë) një viti; ose llogaritet sikur tërë natën e Kadrit ta ketë kaluar duke bërë ibadet.”⁹⁴

⁹³ EbuVelid Junus b. Ubejdullah Saffar në’ *Kitabu’s-Salat* ‘edhe Taberani në *‘Evsat’*.

⁹⁴ Tirmidhi dhe Ibn Maxhe.

Seid b. Xhubejr transmeton nga Sevban, që Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Kush qëndron në xhami në mes të akshamit dhe jacistë duke u angazhuar me namaz ose lexim të Kur’anit, Allahu Teala do t’ia ndërtojë dy pallate në xhennet, gjatësia e secilit do të jetë 100 vite (ecje) e mes tyre do të jenë bahçet në gjerësi të mjaftueshme për të gjithë njerëzit e botës.⁹⁵

Resulallahu, s.a.v.s., gjithashtu ka thënë:

“Ai që i falë dhjetë reqate në mes të akshamit dhe jacistë, Allahu Teala do t’i ndërtojë një pallat në Xhennet”; e në këtë Omeri, r.a., tha:

- Atëherë do të kemi shumë pallate në xhennet!;

e Resulallahu, s.a.v.s., tha:

- Allahu dhuron më së shumti e më së miri.⁹⁶

Sipas Enes b. Malik, Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Kush e falë namazin e akshamit me xhemat, e pas kësaj edhe dy reqate, e të mos flas asgjë që i takon dynjallëkut, të lexojë në reqatin e parë suren Fatiha, dhjetë ajetet e para të sures Bekare, dy ajetet në vazhdim nga mesi i kësaj sure:

“Zoti juaj është Një, Allahu, nuk ka zot pos Atij që është mëshirëplotë, gjithnjë mëshiron.

Është fakt se në krijimin e qiejve e të tokës, në ndërrimin e natës e të ditës, të anijes që lundron në det që u sjell dobi njerëzve, në atë shi që e lëshon Allahu prej së larti e me të ngjall tokën pas vdekjes së saj dhe

⁹⁵ Është përmendur në *Librin për namazin*, nga Ibn Omeri.

⁹⁶ Ibn Mubarek në *‘Zuhd’*, nga Abdulkerim b. Haris, si mursel.

përhapë në te nga çdo lloj gjallese, në qarkullimin e erërave dhe reve të nënshtruara mes qiellit e tokës, (në të gjitha këto), për një popull që ka mend ka argumente.” 2-Bekare: 163, 164, dhe suren Ihlas 15 herë, e më pas bën rukunë dhe sexhde, e në ajetin e dytë lexon Fatihanë, Ajetul-kursijj, dy ajetet pas tij, tri ajetet e fundit të sures Bekare dhe Ihlas 15 herë, është njoftuar se do t’i jepet shpërblim pa hesap.”⁹⁷

Kurrez b. Vebra, një prej sufive (nga ebdallët), tregon si e luti Hizrin, a.s., që t’ia mësojë një veprim që ta bëj për çdo natë, e Hizri, a.s., iu përgjigj:

- *Kur të falësh namazin e akshamit, kohën deri në namazin e jacisë kaloje në namaz, e mos fol me askë. Përkushtoju atij namazi dhe pas çdo dy reqateve, jep selam. Në secilin reqat lexo një herë Fatihanë dhe tri herë suren Ihlas. Kur të përfundosh me namaz e jacisë, nisu për shtëpi, e mos fol me askë, dhe fali dy reqate (në shtëpi), e lexo në secilin reqat Fatihanë dhe shtatë herë suren Ihlas. Pasi të japësh selam, bjer në sexhde, bëj shtatë herë istigfar dhe shtatë herë thuaj: **Lavdëruar çoftë Allahu, Atij i takon falënderimi, nuk ka zot pos Allahut, Allahu është më i madhi, nuk ka forcë pos Allahut, të Fuqishmit e të Lartësuarit.** Më pas ngritu nga sexhdeja, dhe sa je ulur ngriti duart e thuaj: “O i Gjalli, o i Përhershmi, o i Lartësuari, o Fisniku, o Rabb i atyre që ishin më herët dhe atyre që erdhën më vonë, o Mëshirues dhe Mëshirplotë i kësaj bote dhe i botës tjetër, o Rabb, o Rabb, o Rabb, o Allah, o Allah, o Allah.”*

⁹⁷ Ebu Shejh në *es-Sevab* nga Zijad Mejmun, me dallim të vogël, me zinxhir të dobët të transmetuesve.

Pas kësaj ngritu, ngriti duart dhe lexo këtë dua të njëjtë, e më pas flej ku të duash, i shtrirë në krahun e djathtë e i kthyer kah kibla. Dërgoi salavate Resulallahu, s.a.v.s., deri sa të merr gjumi.

Atëherë Kurrez b. Vebra tha:

- *Më trego nga kush e ke dëgjuar këtë;*

e Hizri a.s., tha:

- *Isha në vizitë te Muhammedi a.s., kur iu shpall kjo dua. Ndodhi në praninë time, prandaj e mësova nga ai që ia mësoi edhe Resulallahut, s.a.v.s..”*

Transmetohet se ai që është i qëndrueshëm në këtë dua dhe në këtë namaz, do ta shohë Resulallahun, s.a.v.s., në ëndërr para se të largohet nga kjo botë. Disa njerëz edhe vepruan kështu, dhe e panë në ëndërr që kanë hyrë në xhennet dhe aty u takuan me peygamberët dhe me Resulallahun, s.a.v.s., i cili ka folur me ta dhe i ka mësuar. Me një fjalë, vlerat e ibadetit në mes të akshamit dhe jacisë janë të shumta, kështu që edhe Ubejdullahu, skllavi i liruar i Resulallahut, s.a.v.s., kur u pyet se a ka urdhëruar Resulallahu, s.a.v.s., të falen edhe namaze tjera përpos namazeve të njohura, tha:

- *Na ka urdhëruar të falet namaz në mes të akshamit dhe jacisë.*

Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

“Kush falë namaz mes akshamit e jacisë, po falë namazin evvabin - namazi i atyre që pendohen dhe i mbështeten Allahut.”⁹⁸

⁹⁸ Tashmë është përmendur në *Librin për namazin*.

Esvedi Nahi tregon: *“Sa herë që e vizitoja Ibn Mesudin mes akshamit dhe jacisë, e gjeja në namaz. E pyeta për hikmetin (urtësinë) e kësaj, e më tha:*

- Në këtë kohë duhet të vazhdohet namazi, sepse është kohë e gafletit.”

Enesi r.a., rregullisht falte namaz në këtë kohë, e për ajetin:

“Zgjuarja natën, me të vërtetë, vepron më fuqishëm dhe shprehjet (mësimet) janë më të kthjellta.” 73-Muzzemmil: 6,

ka thënë:

“Me shprehjen ‘zgjuarja natën’, qëllimi është koha e këtij namazi”;

e gjithashtu ka thënë se për këtë kohë flet edhe ajeti:

“I heqin trupat e tyre prej dyshekëve”

32-Sexhde: 16.

Ahmed b. Ebu Havari tregon:

“E pyeta Sylejman Daranin:

- Ditën po agjëroj, e po ha në mes të akshamit e jacisë. A është kjo më e mirë, apo të ha ditën e në atë kohë të bëj ibadet?; e më tha:

- Bëji të dyja (ditën agjëro, e në mes të akshamit e jacis bëj ibadet); e unë e pyeta:

- Po nëse nuk mundem t’i bëj të dyja?; e ai tha:

- Atëherë mos agjëro, por kohën mes akshamit dhe jacisë kaloje në ibadet.

VLERA E LARTË E NGRITJES PREJ SHTRATIT

AJETET NË KËTË TEMË

“Zoti yt e di se ti dhe një grup i atyre që janë me ty, kaloni në adhurim më pak se dy të tretat e natës ose gjysmën e saj, a një të tretën e saj.”

73- Muzzemmil:20.

“Zgjuarja natën, me të vërtetë, vepron më fuqishëm dhe shprehjet (mësimet) janë më të kthjellta.” 73-Muzzemmil: 6

“I heqin trupat e tyre prej dyshekëve, duke e lutur Zotin e tyre nga frika dhe nga shpresa.” 39- Sexhde: 16.

“A mund të krahasohet ai që falet natën, duke bërë sexhde dhe duke qëndruar në këmbë me jobesimtarin?! 39- Zumer: 9.

“Ata që e kalojnë natën, duke i bërë sexhde Rabbit të tyre, dhe duke ndenjur në këmbë.” 25-Furkan: 64.

“Kërkoni ndihmë me durim dhe me namaz.”

2-Bekare: 45.

Thuhet se me namazin e përmendur këtu mendohet në namazin e natës, për të cilin nevojitet durim dhe luftë me nefsin.

HADITHET NË KËTË TEMË

“Kur personi të flejë, shejtani ia lidhë tri nyje rreth qafës, e me secilën nyje thotë: ‘Fli, para teje është natë e gjatë.’ Nëse personi zgjohet dhe e përmend Allahun Teala, zgjidhet një nyje, kur merr abdes, zgjidhet edhe nyja e dytë, e kur fillon të falet, zgjidhet nyja e tretë, dhe kështu personi bëhet i gjallë dhe i disponuar, e në të kundërtën bëhet i ngadalshëm, me disponim të keq.”⁹⁹

Në një transmetim thuhet se Resulallahut, s.a.v.s., ia përmendën një person i cili gjithë natën e kalonte në gjumë, deri në mëngjes, e Resulallahu, s.a.v.s., tha:

“Atë shejtani e ka urinuar në vesh”¹⁰⁰;

e në transmetim tjetër, Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Shejtani e ka një shurup dhe një pluhur. Kur ia jep njeriut përmes hundës, natyra i bëhet e ashpër. Kur ia jep shurupin, në gjuhë i mbretëron e keqja dhe gjynahu. Kur e spërkat me pluhur, ky fle gjithë natën, deri në mëngjes.”¹⁰¹

Resulallahu, s.a.v.s., gjithashtu ka thënë:

“Dy reqate që personi i falë në mes të natës i janë më të mira se sa kjo botë dhe gjithçka në të. Sikur mos të ishte vështirësi (për ummetin tim), do t’ua bëja këto dy reqate të obligueshme.”¹⁰²

⁹⁹ Muttefekun alejhi, Buhari dhe Muslim nga Ebu Hurejre.

¹⁰⁰ Muttefekun alejhi, nga Ibn Mesud.

¹⁰¹ Teberani nga Enesi, Bezzar nga Semur b. Xhundubi.

¹⁰² Adem b. Ebi Ijas në ‘Sevab’.

Në një hadith *sahih* që e transmeton Xhabiri, thuhet se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Ka një kohë e natës në të cilën nuk ndodhë që personi të kërkojë diçka nga Allahu Teala, e Allahu të mos ia pranojë lutjen”; e në transmetim tjetër:

“...Gjithçka që kërkon nga mirësitë e dynjasë dhe ahiretit, Allahu i jep.”

Mugire b. Shu’be thotë se Resulallahu, s.a.v.s., qëndronte në namaz deri sa këmbët i fryheshin, e kur Ajsha r. anha., e pyeti:

- *A nuk t’i ka falur Allahu Teala gjynahet që i ke bërë dhe që do t’i bësh?*; Resulallahu, s.a.v.s., u përgjigj:

- ***E si pra të mos jem rob falënderues i Tij?***¹⁰³

Nga përgjigja e tij mund të përfundohet se kjo është njëjtë si ngritja e gradës, sepse falënderimi është arsye për ngritje. Në lidhje me këtë, Allahu Teala thotë:

“Nëse bëheni mirënjohës, Unë, me siguri, do t’ju jap edhe më shumë...”14-Ibrahim: 7.

Resulallahu, s.a.v.s., tha:

“O Ebu Hurejre, a dëshiron që Allahu Teala të ketë mëshirë me ty deri sa je gjallë dhe kur të vdesësh, në varr dhe kur të ringjalleth? Ngritu natën dhe fal namaz, duke kërkuar kënaqësinë e Rabbit tënd. O Ebu Hurejre, fal namaz në qoshet e shtëpisë tënde, e drita e shtëpisë tënde do të jetë për ata në qiell sikur drita e yjeve për ata në tokë.”

¹⁰³ Muttefekun alejhi, Buhari dhe Muslim.

Gjithashtu ka thënë:

“Vazhdoni kijamin e natës, sepse ky është ibadeti i të devotshmëve para jush. Zgjuarja natën është ibadet që ofron Allahut, është shpagesë për gjynahet, ilaç që largon sëmundjet trupore dhe largon nga gjynahet.”¹⁰⁴

E ka thënë edhe këtë:

“Secilit që natën falë namaz, dhe e zë gjumi (dhe nuk falë namaz një natë), Allahu do t’ia shkruaj shpërblimin sikur të kishte falur, e gjumin që e ka zënë e ka sadaka nga Allahu.”¹⁰⁵

Resulallahu, s.a.v.s., e pyeti Ebu Dherrin:

- Kur dëshiron të udhëtosh, a e siguron ti furnizimin për atë rrugë?;

e Ebu Dherr pohoi, ndërsa Resulallahu, s.a.v.s., vazhdoi:

- Po me udhëtimin drejt ditës së Gjykimit? A të njoftoj o Ebu Dherr, për atë nga e cila do të kesh dobi atë ditë?

- Më njofto, ti më je më i dashur se nëna dhe babai!;
i tha Ebu Dherr, e Resulallahu, s.a.v.s., vazhdoi:

- Agjëro ditën kur nxehtësia është e madhe, për tmerrin e kijametit, fali dy reqate në mesnatë për egërsinë e varrit, kryeje haxhin për ngjarjet para nesh, dhe fukarasë ndaji lëmoshë, fjalën e bukur thuaje, e të shëmtuarën heshte.¹⁰⁶

¹⁰⁴ Tirmidhi, nga Bilalli, Taberani dhe Bejheki nga Ebu Umame, me zinxhir të mirë, e Tirmidhi thotë që është i besueshëm.

¹⁰⁵ Ebu Davudi, Nesai nga Ajshe, r.anha.

¹⁰⁶ Ibn Ebu Dunja në ‘Kitabu’t-Tehexhxhud’ nga Serijj b. Mahled, si mursel.

Transmetohet se në kohën e Resulallahut, s.a.v.s., ishte një person që, kur të gjithë shkonin në gjumë, ai ngritej dhe falej, lexonte Kur'an dhe i thoshte këto fjalë:

- *Ja rabben-nari exhirni minha;*

(O Rabb i zjarrit, më mbrojë nga zjarri!).

I treguan Resulallahut, s.a.v.s., e ai kërkoi që herën tjetër ta njoftojnë. Ashtu bënë, Resulallahu, s.a.v.s., e dëgjoi, e në agim, e pyeti:

- *Pse nuk e lut Allahun Teala për xhennet?*, e ai tha:

- *Me veprat e mia, nuk meritoj të lutem për xhennet!*

Pas një kohe erdhi Xhebraili, a.s., dhe tha:

- *Lajmërojeni* (këtë personin) **se Allahu Teala do ta mbrojë nga zjarri dhe do ta dërgojë në xhennet!**

Xhebraili, a.s., i tha Resulallahut, s.a.v.s.:

- *Sa njeri i mirë që është ky Ibn Omeri! Sikur edhe të falte namaz natën;*

dhe Resulallahu, s.a.v.s., e lajmëroi, dhe Ibn Omeri nisi që rregullisht ta falte namazin e natës.¹⁰⁷

Nafiu, skllavi i liruar i Ibn Omerit ka thënë:

“(Ibn Omeri) Falte namaz natën, dhe më pyeti se a është agimi afër. I thashë që nuk është, e vazhdoi të falej. Përsëri më pyeti a është agimi afër, e kur i thash që është, u ul dhe bëri istigfar, deri në mëngjes.”

¹⁰⁷ Buhari dhe Muslim nga Ibn Omeri, por nuk përmendet Xhebraili, a.s..

Alia, r.a., ka thënë:

“Jahja b. Zekerija a.s., një natë hëngri bukë elbi, deri sa u ngop, dhe e kaloi kohën e virdit në gjumë, deri në mëngjes. Atëherë Allahu Teala iu drejtua me fjalët:

- O Jahja, a mos gjete shtëpi më të mirë se shtëpia Ime? Apo ke gjetur shoqëri më të mirë se Unë?! Pasha fuqinë Time, o Jahja, sikur vetëm një shikim t'ia hedhësh xhenetit, nga dëshira e malli për të hyrë në xhennet do të shkriheshe. E sikur vetëm një shikim ta hedhësh në xhehenem, nga frika do të shkriheshe, në vend të lotëve do të derdhje gjak, e lëkura do të binte, si leckë.”

Resulallahu, s.a.v.s., ju tha me një rast që filan personi natën falet, e kur zbardhet dita, vjedhë e plaçkitë, e Resulallahu, s.a.v.s., tha:

- Namazi do ta largojë nga ato vepra.¹⁰⁸

Resulallahu, s.a.v.s., gjithashtu ka thënë:

“Allahu Teala do ta mëshirojë atë që zgjohet natën, falë namaz, e më pas e zgjon gruan, e edhe ajo falet, ose e spërkat lehtë me ujë fytyrës, nëse ajo refuzon të zgjohet”¹⁰⁹,

“Allahu Teala do ta mëshirojë gruan që zgjohet natën, falë namaz, e më pas a zgjon burrin, e edhe ai falet, ose e spërkat lehtë me ujë, nëse ai refuzon të zgjohet.”¹¹⁰

¹⁰⁸ Ibn Hibban, nga Ebu Hurejre.

¹⁰⁹ Ebu Davud dhe Ibn Maxhe nga Ebu Hurejre.

¹¹⁰ Ebu Davud dhe Nesai nga Ebu Hurejre.

“Ai që zgjohet natën, dhe e zgjon edhe gruan e vet, e i falin dy reqate, do të shënohet, bashkë me gruan, nga ata që bëjnë shumë dhikr”¹¹¹,

“Namazi më i mirë (më i vlefshëm) pas farzit, është namazi i natës.”¹¹²

Sipas Omerit, r.a., Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Atij që në gjumë i kalon viridi, e më pas e lexon në mes të sabahut dhe namazit të drekës, do t’i shkruhet sikur ta ketë lexuar gjatë natës.”¹¹³

Transmetohet që Omeri, r.a., në kuadër të virdit të natës kur nuk mund të lexojë një ajet, u alivanos dhe iu keqësua gjendja për disa ditë, sa edhe nisën ta vizitojnë, si të sëmurin. E Ibn Mesud r.a., kur të gjithë shkonin në gjumë, ngritej për namaz dhe nga leximi i tij dëgjohej gumëzhimë, sikur gumëzhima e bletëve, deri në agim. Sufjan Sevri një natë hëngri deri në ngopje, e tha:

*“Edhe gomari punon më shumë kur ha më shumë”,
dhe e kaloi atë natë në namaz, deri në agim.*

Tavusi, kur shtrihej në shtrat, rrotullohej, si kokra në tavë, e më pas ngritej dhe falte namaz deri në agim, dhe thoshte: *“Përmendja e xhehenemit e humbi gjumin e të devotshmit.”*

¹¹¹ Ebu Davud dhe Nesai nga Ebu Hurejre dhe Ebu Seid.

¹¹² Muslimi, nga Ebu Hurejre.

¹¹³ Muslimi.

Hasani Basriu ka thënë: *“Nuk di një ibadet më të vlefshëm se sa namazi i natës dhe harxhimi i pasurisë (për mirësi)”*; e kur e pyetën:

- *Përse ata që falin namaz të natës kanë pamjen më të bukur mes njerëzve?*, u përgjigj:

- *Vetmohen me Mëshiruesin (Rahmanin), e Ai i mbulon me nur.*

Me një udhëtim, Hasani arriti te disa njerëz të mirë e të ndershëm, që i përgatitën shtratin në të cilën fjeti e nuk u zgjua për virdet. Atëherë u pat betuar që kurrë më nuk do të flejë në shtrat.

Abdulaziz b. Ebi Ruvad, kur vinte nata, shkonte deri te shtrati, e duke kaluar me dorë nëpër të, thoshte: *“Ti vërtetë je i butë, por, pasha Allahun, në xhenet ka edhe më të butë se ti”*, e më pas falte namaz deri në sabah.

Fudl b. Abbas r.a., ka thënë: *“Vjen nata, e më shashtisë gjatësia e saj. Pastaj filloj të lexoj Kur’an, dhe vjen agimi e unë nuk arrij as ta kënaq nevojën dhe dëshirën time për ibadet.”*

Hasan Basriu ka thënë: *“Njeriu mund të bëjë ndonjë gjynah për të cilin privohet nga namazi i natës.”*

Fudajl ka thënë: *“Nëse nuk mund të falesh natën, dhe nuk agjëron ditën, dije se je i privuar nga mirësia, dhe se ke shumë gjynahe.”*

Sila b. Eshjem falte namaz gjithë natën, e kur afrohej agimi, thoshte: “ O Allahu im, njerëzit si unë nuk e kërkojnë xhenetin, por më mbroj nga zjarri me rahmetin Tënd.”

Dikush i tha një dijetari:

- *Jam shumë i dobët për ibadet natën; e ky i tha:*
- *O vëlla, mos bëj gjynah gjatë ditës, sepse për këtë nuk mund të falësh namaz natën.*

Hasan b. Salih e kishte një robëreshë që ia shiti një personi, e kur u bë mesnatë, ajo u ngrit e bërtiti:

- *O banorë të kësaj shtëpie, namazi, namazi!*
- *A është koha e agimit?,* thanë, e ajo i pyeti:
- *A ju i falni vetëm namazet farz?*
- *Po,* i thanë, e pas kësaj ajo shkoi te Hasani, e i tha:
- *Më ke shitur te njerëzit që falin vetëm namazet e farzit. Unë nuk mund të qëndroj mes tyre. Më kthe!,*
dhe Hasani e kthehu.

Er-Rebi' ka thënë: “*Kam kaluar shumë netë në shtëpinë e Shafisë; ai flinte vetëm një pjesë të vogël të natës.*”

Ebu Xhubejsia ka thënë: “*Isha bashkëudhëtar i Ebu Hanifes për gjashtë muaj, e asnjë natë nuk u shtri.*”

Ebu Hanife rrinte zgjuar gjysmën e natës, e me një rast kaloi pranë disa njerëzvetë cilët thanë:

- *Ky rri zgjuar gjithë natën;*
e Ebu Hanife atëherë tha:

- Turpërohem të më përshkruajnë çfarë nuk jam;
e filloi të rri zgjuar gjithë natën, dhe tregohet se nuk
kishte fare shtrat.

Malik b. Dinar tërë natën e përsëriste ajetin:

**“A mendojnë ata që bëjnë vepra të këqia se, Ne,
do t’i bëjmë të njëjtë me ata që kanë besuar dhe që
kanë bërë vepra të mira, se jeta dhe vdekja e tyre do të
jetë e njëjtë? Sa gjykim i keq që është ky!”**

45-Xhathije: 21

Mugire b. Habib ka thënë: *“Po e shikoja Malik b.
Dinar, mori abdes pas jacisë, shkoi te vendi i namazit
dhe e kapi mjekrën e vet. Gulçonte në lotë, e thoshte:*

*- Rabbi im, ndaloja zjarrit mjekrën e zbardhur të
Malikit, Rabbi im, Ti i dallon banorët e xhenetit nga
banorët e xhehenemit, prandaj prej të cilëve është
Maliki? Dhe cila prej atyre dyjave është shtëpia e
Malikt?”; dhe kjo zgjaste deri në agim.*

Malik b. Dinar tregon: *“Një natë fjeta dhe nuk e
bëra virdin tim, e në ëndërr pashë një robëreshë të
bukur, e në dorë mbante një copë letër, dhe më pyeti se
a di të lexoj. I tregova që di, e ajo ma dha letrën, ku
shkruante:*

*Nga vajzat e pastra të xhenetit,
Kënaqësitë e vogla të largojnë?
Atje vdekje nuk ka,
Me to kënaqesh përgjithmonë.
Më mirë e ke të jesh zgjuar,
Kur’an duke lexuar.*

Transmetohet se Mesruk shkoi në haxh, dhe secilën natë e kalonte në sexhde. Ez'her b. Mugis, që e kalonte gjithë kohën në namaz, thotë se ka parë në ëndërr një grua që nuk përngjante me gratë e kësaj bote, dhe ky e pyeti:

- *Kush je ti?*
- *Jam hyri, u përgjigj ajo, e Ez'her i tha:*
- *Martohu me mua!*
- *Më kërko nga Pronari im dhe jep mehr për mua!,*
i tha ajo, e Ez'her e pyeti:
- *Çka është mehri për ty?*
- *Shumë ibadet natën; iu përgjigj ajo.*

Jusuf b. Mihran ka thënë: *“Kam dëgjuar se nën Arsh është një melek në formë të gjelit, me kthetra nga xhevahirët, e mamuz nga argjendi. Kur kalon një e treta e natës, ai i jep me krahë, nis këndimin dhe thotë:*

- ***Le të ngriten ata që ngriten natën!*** Kur kalon gjysma e natës, i jep me krahë, nis këndimin dhe thotë:

- ***Le të ngriten ata që natën e kalojnë në namaz!*** Kur kalon dy të tretat e natës, i jep me krahë, nis këndimin dhe thotë:

- ***Le të ngriten namazlitë!*** Në agim, i jep me krahë, nis këndimin dhe thotë:

- ***Le të zgjohen të pakujdesshmit, që janë mbushur me gjynahe!”***

Për Vehb b. Munebbih Jemanij thuhet se tridhjetë vite nuk është shtrirë, dhe që ka thënë: *“Më mirë ta shoh shejtanin në shtëpi, se jastëkun; sepse jastëku më fton në gjumë.”*

E kishte një jastëk prej lëkurës, në të e mbështeste dorën kur e lodhte gjumi, flinte pak dhe përsëri i kthehej namazit.

Dikush ka thënë: *“E pashë në ëndërr Rabbin tim dhe e dëgjova të thotë:*

- Pasha madhështinë Time, vërtetë e vlerësoj gradën e Sulejman Tejmisë, sepse ai për katërdhjetë vite e falë namazin e sabahut me abdes të jacisë.”

Transmetohet se Sulejman Tejmi konsideronte se gjumi, kur e kaplon zemrën, e prishë abdesin. Në disa libra të vjetër thuhet se Allahu Teala ka thënë:

“Robi Im i vërtetë është ai që, për t’u zgjuar, nuk e pret këndimin e gjelit.”

SEBEPET QË LEHTËSOJNË ZGJIMIN NATËN

Dije se: zgjimi natën është i vështirë, përpos për atë që ndërmerr masa që e lehtësojnë këtë. Ato mund të jenë masa të jashtme (*zahir*) dhe të brendshme (*batin*).

Të jashtme janë katër:

1. Të mos hajë shumë, sepse atëherë edhe do të pijë shumë dhe e pushton gjumi e do t'i vijë vështirë të zgjohet. Disa shejherë qëndronin pranë sofrës së akshamit të muridëve duke thënë:

- O ju që e dëshironi Allahun, mos hani shumë sepse edhe do të pini shumë, prej kësaj edhe do të fleni shumë, e pastaj kur të vdisni do të jeni pishman shumë.

Kjo është baza për zgjim natën që nënkupton lehtësimin e barkut nga ushqimi i rëndë.

2. Ditën të mos merret me punë që i lodhin duart dhe këmbët, dhe që dobësojnë nervat, sepse edhe kjo është arsye për gjumë.

3. Të mos e braktisë gjumin e pasdrekës (*kajlule*) sepse është sunnet që ndihmon të zgjohemi natën¹¹⁴.

4. Që ditën të mos bëj vepra të këqija dhe gjynahe, sepse kjo gjendje e bën zemrën të ngurtë dhe bëhet pengesë mes tij dhe asaj që e siguron mëshirën e Allahut Teala.

Një person i tha Hasan Basriut:

- O Ebu Seid, Unë shkoj në gjumë i qetë, e dua zgjimin natën dhe përgadis ujin për abdes. Përse nuk po mund të zgjohem natën?, e Hasani iu përgjigj:

- Po të pengojnë gjynahet tua.

¹¹⁴ Ibn Maxhe nga Ibn Abbas, dhe është përmendur më herët.

Kur Hasani shkoi në pazar, dhe dëgjoni zhurmën e thashethemet e njerëzve, tha: *“Mendoj që nata e tyre është e keqe dhe e prishur, sepse nuk flejnë pas drekës.”*

Sufjan Sevri ka thënë: *“Pesë muaj nuk munda të ngritem natën, për një gjynah që e bëra”*; e kur e pyetën se çfarë gjynahu ishte, tha:

- *E pashë një person të qajë, e me vete mendova se është dyfytyrësh.*

Një person ka treguar: *“Një ditë e vizitova Kurrez b. Vebrin, dhe e gjeta duke qarë, e i thashë:*

- *Mos të ka ardhë lajm për vdekjen e ndonjë familjari?*

- *Edhe më keq; m’u përgjigj ai.*

- *Çfarë ka ndodhur? I thashë unë, e ai m’u përgjigj:*

- *M’u mbyll dera dhe perdja m’u lëshua. Nuk e lexova virdin tim dje, e kjo ndodhi vetëm për shkak të gjynahut që e bëra, sepse e mira sjellë të mirën, e keqja të keqen, e pak prej njëres ose tjetres, sjell të shumtën e saj.”*

Ebu Sulejman Darani ka thënë: *“Askujt prej jush nuk i ikë namazi me xhemat, përpos për shkak të gjynahut”*;

e gjithashtu ka thënë:

“Ndotja është dënim natën, e papastërtia (pas marrëdhënies intime) largon nga rahmeti.”

Një dijetar ka thënë: *“Kur të agjërosh, kujdes te kush bën iftar, dhe me çka, sepse njeriu mund të hajë diçka nga e cila zemra i ndryshohet, dhe më nuk i kthehet në gjendjen e mëparshme”.*

Të gjitha gjynahet shkaktojnë ngrutësim të zemrës dhe pengojnë zgjuarjen natën, e më së shumti ka ndikim ushqimi haram. Asgjë nuk mund të ndikojë në pastrim të zemrës dhe ta kthejë atë kah e mira, siç ndikon një kafshatë hallall. Këtë e dinë ata që e kontrollojnë zemrën e tyre, dhe me përvojë. Prandaj disa kanë thënë: *“Sa shumë ka ushqime që pengojnë zgjuarjen natën, sa shumë ka shikime gjynahqare që pengojnë mësimin e një sureje të Kur’anit. Njeriu mund të ha një ushqim ose të bëj një vepër të keqe, e kjo ta pengojë të zgjohet natën, për një vit. Siç largon namazi nga veprat e shëmtuara e nga shfrenimi, njëjtë edhe shfrenimi dhe veprat e shëmtuara largojnë nga namazi dhe nga veprat tjera të mira.”*

Një roje burgu ka thënë: *“Isha roje për më shumë se tridhjetë vite dhe gjithmonë i pyesja të burgosurit që vinin se a e kanë falë namazin e jacisë me xhemat, e secili më ka thënë jo.”*

Kjo dëshmon që namazi me xhemat largon nga veprat e këqija.

Masa të brendshme gjithashtu janë katër:

1. Largimi nga zemra i urrejtjes për myslimanët, largimi nga bidatet dhe nga interesimi i tepërt për dynjanë, sepse ai që e tepron në këtë nuk mund të zgjohet natën, e nëse zgjohet, nuk mendon për namaz, por për obligimet dhe brengat e kësaj bote. Në një poezi thuhet:

*Portieri më lajmëroi se ti je në gjumë,
por edhe kur të zgjohesh, ti prapë je në gjumë.*

2. Frika që nuk e braktisë zemrën, dhe pritjet. Kur njeriu mendon për vështirësitë e ahiretit dhe tmerret e xhehenemit, i pakësohet gjumi e i shtohet frika. Në këtë kuptim, Tavusi ka thënë: *“Përmendja e xhehenemit, besimtarit ia largon gjumin.”*

Tregohet se një skllav në Basra i quajtur Suhejb, tërë natën e kalonte në namaz. Pronarja e tij i tha:

- *Qëndrimi zgjuar natën po ta dëmton punën ditën, e ai u përgjigj:*

- *Kur e kujtoj xhehenemin, nuk më vjen gjumë në sy.*

Njëjtë iu tha edhe një skllavi tjetër, i cili gjithashtu tërë natën e kalonte në namaz, e ky u përgjigj:

- *Kur e kujtoj zjarrin e xhehenemit, më shtohet frika, e kur e kujtoj xhennetin, më shtohet dëshira dhe malli, prandaj nuk po mundem të flej.*

Zunnun Misri ka thënë:

“Sytë që e kuptuan nga Kur’ani se si Allahu Teala ka përgatitë për besimtarët xhennetin dhe si ka përgatitë për armiqtë xhehenemin, karshi madhësisë së Tij u përkulën me respekt dhe sakrifikuan gjumin.”

Edhe në një poezi thuhet:

O ti që aq shumë po fle,

nga kjo vetëm pendim e vuajtje ke.

Vallë je i sigurar që Azrail shpirtin nuk ta merr?

shumë futen në shtrat të sigurt, e Azraili i nxjerrë.

Një ditë në varr kur të lëshohesh,

gjatë do të flesh, deri sa të zgjohesh;

Aty do të kesh edhe shtratin shtruar,

i bërë nga gjynahet a të mirat, që i ke vepruar.

Ibn Mubarek ka thënë: *“Disa zgjohen nga gjumi sapo nata të errësojë, e mbesin në ruku, sepse frika ua largon gjumin. Të pavëmendshmit që jepen pas dynjasë, i pushton gjumi dhe e humbin rastin.”*

3. Të njohë vlerën e zgjimit natën, duke dëgjuar ajete, hadithe dhe transmetime që flasin për këtë, ashtu që shpresat, dëshira dhe malli për këtë t’i forcohen përmes shpërblimit të lajmëruar, dhe që kjo ta shtyejë të kërkojë edhe më shumë dhe të kërkojë gradat më të larta në xhennet. Tregohet se një person i ndershëm dhe i devotshëm (salih) po kthehej nga një betejë, e gruaja ia përgatiti shtratin. Por, ai shkoi në xhami dhe fali namaz gjithë natën, e në mëngjes, gruaja i tha:

- *Ta përgaditëm shtratin, por ti nuk erdhe;* e ai tha:

- *Vallahi, e mendova xhennetin dhe kënaqësitë në xhennet, e për të hyrë aty e harrova shtëpinë dhe gjithë natën fala namaz.*

4. Ky është motivi më i ndershëm, e ka të bëjë me dashurinë ndaj Allahut dhe me fuqinë e besimit; me secilën fjalë që lexon personi në namaz bisedon me Allahun, bile në gjithçka që mendon, është i vetëdijshëm që Allahu di, dhe për kujtimet që lindin në zemër, e di se është frymëzim hyjnor. Kur njeriu e dashuron Allahun, gjithsesi vetmohet dhe kënaqet në bisedimin me Të, e kjo e nxitë që gjithë natën ta kalojë në namaz. Nuk duhet parë të paarritshme e të përjashtohet mundësia e kësaj kënaqësie, sepse për këtë dëshmojnë edhe mendja edhe përvoja.

Kur flasim për mendjen, njeriu duhet të shohë se si ai që e do një person për shkak të bukurisë, ose ndonjë të pasur për shkak të pasurisë, kënaqet në bisedë me të në ndonjë vend intim e gjumi nuk e zë gjithë natën. Nëse thua se njeriu kënaqet në bisedë me personin e bukur për shkak që e sheh atë, ndërsa Allahun nuk e sheh, atëherë dije se ai që dashuron, edhe po të ishte e dashura e tij pas ndonjë mbulese apo në hapësirë të errët, ky do të kënaqej me afërsinë e saj edhe pse nuk e sheh, dhe do të mjaftojë. Do të kënaqej duke i shprehur dashurinë dhe duke ia përmend emrin, që ajo ta dëgjojë, ani pse ajo tashmë e di se ky e dashuron. Nëse thua se njeriu merr kënaqësi nga kjo bisedë me atë person për shkak se pret përgjigje prej saj, që këtij do t'i jetë kënaqësi, e nga ana tjetër të folurit e Allahut Teala nuk dëgjohej, dije se ai që e dashuron Allahun Teala e di se Ai nuk do t'i përgjigjet në bisedë, por kënaqësinë e gjen në zbulimin e gjendjeve të veta, fshehtësive të veta dhe mendimeve të fshehta që i dalin përpara.

E si kështu? Ai që beson fuqishëm në Allahun Teala, i dëgjon të gjitha përgjigjet që Allahu ia dërgon zemrës së tij gjatë kësaj bisede, dhe këtu e gjen kënaqësinë. Njëjtë me atë i cili vetmohet me pasanikun, të cilit ia paraqet nevojat e veta, duke u kënaqur me shpresën se i pasuri do të ketë mëshirë. E shpresa në mëshirën dhe shpërblimin e Allahut është më e sinqertë. Ajo që është te Allahu është më e mirë, më e vlefshme dhe më afatgjatë se sa ajo që është me të tjerët. E si pra të mos gjejmë kënaqësi kur Atij i shprehim nevojat tona, në fshehtësi?!

Sa për përvojën, duhet të thuhet se për mundësinë e kësaj kënaqësie dëshmojnë gjendjet e atyre që natën bëjnë ibadet, duke e konsideruar natën të shkurtë, siç është rasti edhe me të dashuruarin në natën e parë me të dashurën. Njërin prej tyre e pyetën:

- *Si kalon këto netë të gjata?*, e u përgjigj:

- *Unë nuk e kuptoj natën; ma tregon fytyrën, e më pas kalon shumë shpejt, dhe arrin mëngjesi.*

E tjetri ka thënë: *“Unë e nata jemi si dy kuaj vrapues; nganjëherë ma kalon e mbërrinë para meje në agim, e nganjëherë m’i ndërprejnë mendimet.”*

Njërin e pyetën:

- *Si të kalon nata?*; e ai tha:

- *Kalon shumë shpejt! Jam mes dy gjendjeve; i gëzohem errësirës së saj kur vjen, e mërzitem kur agon. Ende nuk arrita ta plotësoj kënaqësinë.*

Ali b. Bekkar ka thënë: *“Ka katërdhjetë vite që asgjë pos agimit nuk më mërzitë...”*

Fudajl b. Ijad ka thënë: *“Kur Dielli perëndon, i gëzohem errësirës për shkak se mbetem vetëm me Rabbin tim, e kur agon, mërzitem, sepse duhet të angzohem me njerëz.”*

Ebu Sulejman Darani ka thënë: *“Ata që natën bëjnë ibadet më shumë kënaqen natën se sa që kënaqen në zifafete e gosti ata të cilëve këto ju pëlqejnë. Po të mos ishte nata, nuk do ta donin të jetojnë në këtë botë”;*

dhe gjithashtu ka thënë: *“Sikur Allahu Teala t’ju jepte shpërblimin që e ka caktuar për ata që bëjnë ibadet natën, kënaqësia e tyre do të ishte edhe më e madhe se shpërblimi!”*

Disa dijetarë kanë thënë: *“Nga kjo botë, e barabartë me kënaqësinë e banorëve të xhenetit është vetëm kënaqësia e atyre që bëjnë ibadet natën”;*

E disa kanë thënë: *“Kënaqësia e ibadetit të natës nuk është e kësaj bote, por nga xheneti. Allahu Teala ia zbulon atë vetëm pasueve të vet të vërtetë.”*

Ibn Munkedir ka thënë: *“Kanë mbetur vetëm tri kënaqësi në këtë botë: ibadeti i natës, takimi mes vëllezërve dhe namazi me xhemat.”*

Disa të dijshtëm kanë thënë: *“Në agim, Allahu Teala shikon në zemrat e atyre që janë të zgjuar nga gjumi dhe i mbushë me nur. Zemrat u mbushen me hikmet (urtësi), që pastaj shpërndahet në zemrat e gafilëve.*

Disa dijetarë nga gjeneratat e para kanë treguar: *“Një personi të sigurtë e të besueshëm, Allahu Teala përmes frymëzimit, i shpalli:*

- Ka disa njerëz që Unë i dua, e edhe ata Mua më duan, kanë mall për Mua e edhe Unë kam mall për ta, më përmendin Mua e edhe Unë i përmendi ata, ata më shikojnë Mua e edhe Unë i shikoj ata. Nëse ti e ndjekë rrugën e tyre, do të Dua, e nëse largohesh nga kjo rrugë, do të Urrej.

Ky e pyeti si mund t'i njuh ata, e Allahu Teala i tha:

- Ditën shkojnë pas hijeve, sikur çobani pas bagëtisë, e presin me mall perëndimin e Diellit sikur që zogjë të kanë mall për follenë e tyre, e kur t'i mbulojnë nata e errësira të shtohet e secili i dashuruar të vetmohet me atë që dashuron. Ngriten në këmbë dhe lëshohen me fytyrë për toke, Mua më drejtohen me fjalët e Mia dhe më falënderojnë duke i përmendur bereqetet e Mia, kërkojnë ndihmë dhe qajnë, ankohen dhe ofshajnë. Pasha shikimin dhe dëgjimin Tim, ajo që ata e durojnë dhe përballojnë për Mua dhe për dashurinë ndaj Meje, do të jetë e para që do ta shpërblej. Në zemrat e tyre Unë do të mbjell nurin Tim, e do të flasim për Mua sikur që Unë flas për ta. E dyta: sikur të mateshin me ta shtatë qiej e shtatë Tokë, në krahasim me ta do të ishin të pavlefshme. E treta: Unë ju afrohem atyre, e - a e di dikush çfarë dëshiroj Unë t'i japë atij që i afrohem?"

Malik b. Dinar ka thënë: *"Kur personi ngritet natën për namazin, shpirtërisht i ofrohet Allahut Teala."*

Bile, shfaqjen e kënaqësisë dhe butësinë e zemrës e konsideronin si frut i afërsisë së Allahut. Kjo e ka fshehtësinë e vet, për të cilën do të flasim në *Librin për dashurinë*.

Një murid iu ankua Shejhut të tij në gjatësinë e natës, që të flejë një pjesë të saj, e Shejhu i tha:

- O evlad, Allahu Teala edhe ditën edhe natën ka dhurata që i arrijnë ata që janë të zgjuar e ju ikin atyre që janë në gjumë. Luftoni për ato dhurata!; dhe shtoi:

- Rabbi im, unë nuk flej ditën as natën! E muridi tha:

- Pas këtij shpjegimi, as unë nuk do të flej, as ditën as natën!”

Duhet ditur se natën është mundësia më e madhe për të fituar këto dhurata, për shkak se natën zemrat janë më të sinqerta dhe më pak të angazhuara. Në një hadith *sahih* që e transmeton Xhabiri, thuhet se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Ka një kohë e natës në të cilën nuk ndodhë që personi të kërkojë diçka nga Allahu Teala, e Allahu të mos ia pranojë lutjen.”¹¹⁵; e në transmetim tjetër:

“...Gjithçka që kërkon nga mirësitë e dynjas dhe ahiretit, Allahu i jep.”

Kjo ekziston çdo natë, dhe është e fshehur sikur nata e Kadrit gjatë Ramazanit, ose në ditën e xhumasë. Ky me siguri është ai momenti kur Allahu Teala i shpërndanë dhuratat që u përmendën më lartë, e Allahu e di më së miri.

¹¹⁵ Muslimi.

MËNYRAT E NDARJES SË NATËS

Duhet ditur se qëndrimi zgjuar natën, sipas kohëzgjatjes së vet, i ka shtatë gradë:

1. Zgjuar gjithë natën. Ky është rasti me ata që janë të fortë e të vendosur, të përkushtuar plotësisht ibadetit, që ndjejnë kënaqësi kur i drejtohen Allahut, dhe ibadetet ju bëhen ushqim dhe fuqi. Ata nuk i lodhë qëndrimi në këmbë (*kijam*) i gjatë në namazin e natës, ata flejnë pak gjatë ditës, kur të tjerët merren me obligimet e dynjasë. Kështu vepronin disa nga gjeneratat e para, të cilët me abdes nga jacia falnin edhe sabahun.

Ebu Talib Mekki tregon që ka shumë transmetime se këtë e praktikonin 40 taibinë nga të cilët disa vazhduan me këtë për 40 vjet, e mes tyre: Seid b. Musejjeb e Safvan b. Selim nga Medine, Fudajl b. Ijad e Vuhejb b. Verd nga Meka, Tavusi dhe Vehb b. Munebbih nga Jemeni, Rebi b. Hasejm e Hakemi nga Kufe, Ebu Sulejman Darani e Ali b. Bekkar nga Shami, Ebu Abdullah Havvas e Ebu Asim nga Ibade, Habib Ebu Muhammed e Ebu Xhabir Selmani nga Persia, Malik b. Dinar, Sulejman Tejmi, Jezid Rekashi, Habib ebu Sabit, Jahja Bekka, dhe Kehmes b. Minhal, bile ky i lexonte 90 hatme, e ato që nuk i kuptonte kthehej e i lexonte përsëri, e të gjithë ishin nga Basra. Nga banorët e Medines, mund të përmendim edhe Ebu Hazim, Muhammed b. Munkedir e të tjerë;

2. Zgjuar gjysmën e natës; numri i myslimanëve nga gjeneratat e para që bënë ibadet gjysmën e natës është i pakufi. Në kuadër të kësaj mënyre, më e mira është të flihet në një të tretën e parë të natës si edhe në 1/6 e fundit të saj, e që në namaz të jemi në mes të natës, pasi që është koha më me vlerë;

3. Zgjuar një të tretën e natës. Në këtë rast, duhet të flejë në gjysmën e parë të natës dhe në 1/6 e fundit të saj. Me një fjalë, fjetja në fund të natës është e dëshirueshme, sepse nëse personi falet pjesën më të madhe të natës e fle pak para agimit, i pakësohen zbehja në fytyrë dhe përgjumja e mëngjesit. Ajsha r.anha, thotë:

“Pasi që Resulallahu, s.a.v.s., i falte namazet vitri në fund të natës, i afrohej grave të veta, ose mbështetej aty ku falej deri sa të vinte Bilalli dhe të thërriste ezanin.”¹¹⁶; dhe gjithashtu ka thënë:

“Pas namazit para agimit e gjeja në gjumë.”¹¹⁷

Disa nga gjeneratat e para, ndër ta edhe Ebu Hurejre, kanë thënë se fjetja para sabahut është sunnet. Kjo ka mundësuar largimin e perdes së gajbit për ata që e pastrojnë zemrën e vet. Kjo fjetje e lehtësonte kryerjen e virdit të parë ditor si edhe kalimin e 1/6 së fundit të natës në namaz, që konsiderohet zakon i Davudit, a.s.;

¹¹⁶ Muttefekun alejhi, Buhari dhe Muslim, Nesai dhe Ebu Davud, me dallime të vogla.

¹¹⁷ Muttefekun alejhi, Buhari dhe Muslim, si edhe Ibn Maxhe.

4. Zgjuar në 1/6 ose 1/5 e natës. Më së miri do të ishte që kjo të jetë në gjysmën e dytë të natës, para 1/6 të fundit të saj;

5. Zgjuar, pa e matur kohën, e këtë mundet vetëm Pejgamberi që pranon shpallje, ose ai që i njeh pozitat e Hënës dhe e ngarkon dikë që të vështrojë dhe ta zgjojë. Nganjëherë gabon. Pasi që mund të gabojë në netët me vranësi, në namaz do të kalojë pjesën e parë të natës, deri sa gjumi ta mposhtë. Kur të zgjohet, përsëri falë namaz deri sa përsëri gjumi ta mposhtë, kështu që brenda një nate, flen dy herë dhe zgjohet për namaz dy herë.¹¹⁸ Kjo është më e vështira, por edhe më e vlefshmja. Kështu vepronte Resulallahu, s.a.v.s., e edhe Omeri, r.a., si edhe ata që ishin të fortë e të vendosur nga as'habët dhe taibinët. Dikush nga ta ka thënë:

“Nëse pasi të flej zgjohem e pastaj prapë flej (pa falë namaz), mos i mbyllsha sytë kurrë!”

Sa për sasinë e namazit të natës së Resulallahut, s.a.v.s., ai nuk ishte gjithmonë i njëjtë. Nganjëherë e kalonte në namaz gjysmën e natës, nganjëherë dy të tretat e nganjëherë një të tretën, e nganjëherë një të gjashtëm.¹¹⁹ Për këtë tregon ajeti në vazhdim:

“Me të vërtetë, Rabbi yt e di, se ti (o Muhammed) lutesh më pak se dy të tretat e natës, ndonjëherë gjysmën ose të tretën e saj,” 73-Muzzemmil: 20

¹¹⁸ Ebu Davud, Tirmidhi, dhe Nesai që e konsideron të besueshëm, nga Ummu Seleme, si edhe Buhari nga Ibn Abbas, r.a..

¹¹⁹ Buhari dhe Muslim nga Ibn Abbas, Ebu Davud, Muslimi nga Ajshe r.anha.

Ajshe r.anha, thotë: *“Resulallahu, s.a.v.s., zgjohej të falë namaz kur e dëgjonte këndesin.”*

Kjo ishte 1/6 e fundit e natës, jo më pak. Ka disa transmetime se njëri prej as’habëve ka thënë:

“E vrojtoja namazin e Resulallahut, s.a.v.s., një natë kur ishim në udhëtim, e pas jacisë fjeti një kohë, pastaj u zgjua, shikoi në horizont dhe i lexoi ajetet Kur’anore:

“Për ata që Allahun e përmendin me përkujtim kur janë në këmbë, kur janë ulur, kur janë të shtrirë dhe thellohen në mendime rreth krijimit të qiejve e të tokës (duke thënë): O Rabbi ynë, këtë nuk e krijove kot, i lartësuar qofsh, ruana prej dënimit të zjarrit!

O Rabbi ynë, atë Ti e fute në zjarr, atë e ke poshtëruar; për mizorët nuk ka ndihmëtarë!

O Rabbi ynë, ne dëgjuam një thirrës që ftonte për besim (e që thoshte): Të besoni Rabbin tuaj! E ne besuam! O Rabbi ynë, na i falë mëkatet tona, na i mbulo të metat dhe pas vdekjes na bashko me të mirët!

O Rabbi ynë, jepna atë që nëpërmjet të dërguarëve Tu, na e premtove dhe në ditën e kijametit mos na turpëro; vërtet Ti je Ai që nuk e shkel premtimin!” (3-Ali Imran: 191-194),

e më pas nxorri misvakun, i pastroi dhëmbët, mori abdes, fali ende namaz e pastaj fjeti. U shtri, dhe fjeti po aq kohë sa fali namaz. Më pas u zgjua, lexoi atë që e lexoi edhe herën e parë, dhe veproi siç veproi edhe herën e parë.”¹²⁰

¹²⁰ Nesai nga Hamid b. Abdurrahman b. Avf për njërin nga as’habët. Ebu Velid b. Mugis në *es-Salat* nga Is’hak b. Abdullah b. Ebu Talha.

6. Kjo është mënyra më e shkurtë e qëndrimit zgjuar, e nënkupton kohën e nevojshme që të falen katër ose dy reqate, ose në rast se personi nuk mund të marr abdes për ndonjë arsye, të qëndrojë një kohë ulur e i kthyer kah kibla, në dhikr dhe dua, sepse për të gjithë që zgjohen natën për ibadet është caktuar mëshira e Allahut Teala. Në një transmetim thuhet:

“Fal namaz natën, qoftë edhe për aq kohë sa mjelet delja!”¹²¹

Këto janë mënyrat e ndarjes së natës, prandaj njeriu le të zgjedhë atë që i vjen më e lehtë. Nëse nuk mundet të zgjohet në gjysmë të natës, mos ta braktisë namazin në mes të akshamit dhe jacisë, si edhe viridin pas namazit të jacisë. Më pas duhet të zgjohet para agimit, që agimi mos ta zë në gjumë. Kështu, njeriu i kalon në namaz dy kohë të natës, fillimin dhe fundin, që paraqet mënyrën e shtatë të qëndrimit zgjuar.

Këto mënyra të qëndrimit zgjuar janë renditur sipas gjatësisë së tyre. Te mënyra e pestë dhe e shtatë nuk merret parasysh gjatësia, pasi që te këto nuk luan rol gjatësia e as fakti se a fillon më herët apo më vonë nga ajo që këtu u përmend. Mënyra e shtatë e qëndrimit zgjuar nuk e përjashton atë që e përmendëm te mënyra e gjashtë, e as mënyra e pestë nuk e përjashton atë që përmendëm për mënyrën e katërt.

¹²¹ Ebu Ja’la nga Ibn Abbas, si hadith *merfu*. Ebu Velid b. Mugis nga Ijas b. Muavija si *mursel*.

NETËT DHE DITËT ME VLERË

Duhet ditur se janë 15 netë me vlerë të veçantë në të cilat, siç ceket në hadithe, është e lavdëruar të mos flihet dhe të falet namaz. Ato nuk duhet neglizhuar, sepse ato janë “panaire” të veprave të mira dhe depo të mallit për tregti. Kur tregtari i neglizhon panairët dhe ditët e pazarit, kurrë nuk do të fitojë, njëjtë si muridi që nuk do të ketë sukses nëse neglizhon vlerën e ndonjë kohe të caktuar. Gjashtë prej këtyre netëve janë në muajin e Ramazanit, ku pesë prej tyre janë në netët tek të një të tretës së fundit të muajit, meqenëse aty ndodhet nata e Kadrit, si edhe nata e shtatëmbëdhjetë e Ramazanit, në orët e hershme të mëngjesit të së cilës ndahet gënjeshtra nga e vërteta, dita kur luftuan dy grupe, pra beteja në Bedr. Sipas Ibn Zubejrit është nata e Kadrit.

Nëntë të tjera nga pesëmbëdhjetë të përmendurat janë: nata e parë e muajit Muharrem, dhe netët e Ashures, nata e parë, e pesëmbëdhjetë dhe e njëzet e shtatë e muajit Rexhep, e kjo e fundit është edhe nata e Miraxhit në të cilën posaçërisht falet një namaz, në lidhje me të cilin Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

“Atij që bën ibadet në këtë natë, do t’i shkruhet sikur të ketë bërë vepra të mira për njëqind vjet.”¹²²

¹²² Ebu Musa el-Medini në ‘Kitabu *Fedail el-ejjam ve el-lejali* nga Hakimi.

Atij që në këtë natë i falë dymbëdhjetë reqate, në secilin lexon Fatihanë dhe një sure nga Kur'ani e në çdo të dytin reqat jep selam e më pasë njëqind herë thotë:

Subhanal-lahi, vel-hamdu lil-lahi, ve la ilahe ilal-lahu val-lahu ekber (i Lavdëruar qoftë Allahu Teala, Atij i qoftë hamd, nuk ka zot tjetër pos Allahut, Allahu është Madhështori),

njëqid herë bën istigfar, njëqind herë i dërgon salavat Resulallahut, s.a.v.s., e lutë Allahun Teala për atë që e dëshiron në këtë botë ose në botën tjetër, dhe mëngjesi e gjen duke agjëruar, Allahu Teala do t'ia plotësojë të gjitha dëshirat, përpos të këqijave.

Pastaj aty është nata e pesëmbëdhjetë e muajit Shaban, në të cilën falen njëqind reqate, ku në secilin, pas fatihasë lexohet dhjetë herë surja Ihlas. Siç e kemi shpjeguar në kapitullin për namazet nafile, as'habët nuk e lëshonin pa falë këtë namaz. Është edhe nata e Arefes, si edhe netët para Bajramit, për të cilat Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Kush e kalon në ibadet natën para Bajramit, zemra nuk do t'i vdesë në ditën kur vdesin zemrat.”¹²³

E ditët me vlerë të veçantë janë nëntëmbëdhjetë. Në to është e lavdërueshme të bëhet ibadet. Këto janë: dita e Arefes, dita e Ashures, dita e njëzet e shtatë e muajit Rexhep, që ka vlerë shumë të madhe, për çka flet edhe hadithi nga Resulallahu, s.a.v.s., që e transmeton Ebu Hurejre:

¹²³ Ibn Maxhe nga Ebu Umame.

“Kush agjëron ditën e njëzet e shtatë të muajit Rexhep, Allahu Teala do t’ia shkruajë sikur të ketë agjëruar gjashtëdhjetë muaj.”¹²⁴

Kjo është dita në të cilën Allahu Teala e dërgoi Xhebrailin a.s., me shpallje te Muhammedi, s.a.v.s.. Pastaj është dita e shtatëmbëdhjetë e muajit Ramazan, e që është dita e betejës së Bedrit, dita e pesëmbëdhjetë e muajit Shaban, e premtja, dy Bajramet, ditët e *njohura (ejjam-i ma’lumat)*, e që janë dhjetë ditët e muajit Dhul-hixhhet dhe ditët e *numëruara (ejjam-i ma’dudat)*, e që janë ditët e Kurban Bajramit.

Enesi transmeton se Resulallahu. s.a.v.s., ka thënë:

“Kur e premtja të jetë e sigurtë, edhe ditët tjera janë të tilla, e kur Ramazani të jetë i sigurtë, edhe gjithë viti është i tillë.”¹²⁵

Një dijetar ka thënë: *“Kush mundohet dhe kujdeset për pesë ditë në këtë dynja, nuk do të ketë brenga në ahiret”*; e me këtë ka menduar në dy Bajramet, xhumanë, Arefe dhe Ashure.

¹²⁴Ebu Musa Medini në *Fedailul-ejjam vel-lejali* nga Shihr b. Havsheb.

¹²⁵Është përmendur në kapitullin e pestë të *Librit për namazin*, ku përmendet vetëm e premtja. Të plotë e transmeton Ibn Hibban në *ed-Du+afa* dhe Ebu Nuajm në *el-Hilje* nga Ajshe r.anha, por është hadith i dobët.

Gjatë javës, ditë me vlerë të veçantë janë e enjte dhe e hënë, në të cilat veprat e njerëzve ngriten te Allahu Teala. Për vlerat e ditëve dhe muajve në të cilat agjërohet kemi folë në *Librin për agjërimin*, prandaj nuk ka nevojë që këtu ta përsërisim, e Allahu Teala e di më së miri. Salat dhe selame të shumta qofshin mbi Muhammedin s.a.v.s., familjen e tij (Ehli-bejt), as'habëve të tij dhe atyre që pasojnë ahlakun dhe sunnetin e tij.

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	3
VLERA E LARTË, RENDITJA DHE RREGULLAT E E VIRDIT	5
NUMRI DHE RENDITJA E EVRADIT	11
EVRAZI DITOR.....	11
EVRAZI I NATËS.....	43
NDËRRIMI I VIRDEVE SIPAS GENDJEVE	67
NETËT E LAVDËRUARA PËR RIGJALLËRIM ME IBADET, FAZILETI I IBADETIT TË NATËS DHE PJESËT E NATËS PËR IBADET	79
FAZILETI I IBADETIT MES AKSHAMIT DHE JACISË.....	79
VLERA E LARTË E NGRITJES PREJ SHTRATIT	84
AJETET NË KËTË TEMË	84
HADITHET NË KËTË TEMË	85
SEBEPET QË LEHTËSOJNË ZGJIMIN NATËN	96
MËNYRAT E NDARJES SË NATËS	106
NETËT DHE DITËT ME VLERË.....	111

